



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORT PËR FUNKSIONIMIN E KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Janar - Dhjetor 2020

Prishtinë, 2021

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Hyrje.....	4
Metodologjia	5
Përmbledhje ekzekutive	6
FUNKSIONIMI I KOMUNAVE	9
Kuvendi i Komunës	9
Komitetet e Kuvendit të Komunës.....	10
Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative	11
Aktet e kuvendeve të komunave	12
Transparenca dhe llogaridhënia komunale	13
Siguria në Bashkësi	16
Mbikëqyrja e komunave	19
AGJENDA EVROPIANE.....	24
Kriteret politike.....	25
Kriteret ekonomike.....	28
Standardet Evropiane.....	30
FINANCAT LOKALE	37
Planifikimi i të hyrave vetanake	37
Realizimi i të hyrave vetanake	37
Buxhetimi Komunal për vitin 2020	39
Shpenzimet krahasuar me buxhetimin	39
Shpenzimet nga programi për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE)	40
Shpenzimet për Menaxhim Emergjent nga COVID 19	41
Opinionit i auditorit për komunat e Republikës së Kosovës	42
Rekomandimet	43

Shkurtesat

AE	Agjenda Evropiane
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
EVS	Ekipet Vepruese për Siguri
KK	Kuvendi Komunal
KKSB	Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshilli Lokal për Siguri Publike
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
ML	Ministritë e Linjës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
PKZMSA	Programi Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit
PL	Pushteti Lokal
PQ	Pushteti Qendror
PRE	Programi për Reformë Ekonomike
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 - 2026
UA	Udhëzim Administrativ

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal gjatë vitit 2020 është përkushtuar në zbatimin e prioriteteve të saja strategjike në funksion të mbështetjes dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Në vitin 2016 ka hyrë në fuqi Strategjia dhjetëvjeçare për Vetëqeverisje Lokale (2016 – 2026), e cila ofron një vizion të qartë për ecurinë e reformës dhe zhvillimit të pushtetit lokal. Në përputhje me objektivat zhvillimore të saj, janë konkretizuar aktivitetet dhe janë përcaktuar një sërë masash të kërkuara veçanërisht nga pushteti lokal. Shtyllë kryesore e synuar mbetet qeverisja e mirë në nivel lokal, transparenca komunale, mbikëqyrja dhe kontrolli i ligjshmërisë, efikasiteti dhe efektiviteti i shërbimeve dhe prioritizimi i obligimeve të komunave nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, për të cilat MAPL është duke punuar ngushtë me nivelin lokal, partnerët, shoqërinë civile dhe akterët tjerë.

Raporti për funksionimin e komunave është dokument që vlerëson progresin e komunave gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020. Ky raport hartohet duke u bazuar në nenin 86 të LVL-së çdo vit deri në fund të muajit Mars dhe i njëjti i dorëzohet Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Qëllimi i këtij raporti është të informohen drejtë: Qeveria, Kuvendi i Republikës së Kosovës, komunat, shoqëria civile, qytetarët dhe grupet tjera të interesit, lidhur me funksionimin dhe progresin e komunave, por edhe sfidave të mbetura. Raporti ofron konkluzionet lidhur me fushat përkatëse dhe jep rekomandimet specifike për komunat për tu adresuar në të ardhmen.

Raporti përmban informacionet si në vijim:

- Përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon fushën e transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore;
- Jep një pasqyrë të opinionëve të auditorit të përgjithshëm për komunat për vitin paraprak

Raporti është produkt i Ministrisë së Pushtetit Lokal – MAPL.

Metodologjia

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuar në procesin e monitorimit të komunave nga Departamentet dhe njësitë përgjegjëse të Ministrisë së Pushtetit Lokal – MAPL.

Lidhur me metodologjinë e raportit, janë përdorur burime të ndryshme të të dhënave, të siguruar nga zyrtarët komunal, si dhe informata të tjera të siguruar nga monitoruesit në terren. Një pjesë e të dhënave janë marrë nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave, si dhe nga raportet për obligimet e komunave që dalin nga agjenda evropiane. Gjithashtu, të dhënat janë siguruar edhe përmes pyetësorëve të dizajnuar për mbledhjen e të dhënave në fushat përkatëse të paraqitura në raport. Raporti ka një metodologji përshkuese (*deskriptive*) dhe analitike të punës së funksionimit të komunave të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020.

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë vitit 2020, komunat kanë shënuar një progres të konsiderueshëm në strukturat e tyre vendimmarrëse për të vazhduar me aktivitetet e planifikuara sipas prioriteteve të tyre strategjike, edhe përkundër faktit që kanë pasur probleme dhe vështirësi të shumta si rezultat i pandemisë globale të COVID – 19. Është parë progres i shtuar i kuvendeve të komunave në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke aprovuar një numër të konsiderueshëm të akteve në pajtim me legjislacionin në fuqi. Për një vit pune, kuvendet e komunave mbajtën 517 mbledhje, prej të cilave 360 kanë qenë të rregullta, 92 të jashtëzakonshme, 39 solemne, 26 urgjente. Pothuajse të gjitha komunat kanë përmbushur standardin ligjor prej 10 mbledhjeve të kërkuara sipas nenit 43.2 të LVL-së. Mbledhjet e mbajtura kanë qenë të hapura për publikun, duke u dhënë mundësinë qytetarëve të informohen rregullisht për zhvillimet e politikave lokale deri në shfaqjen e pandemisë globale të COVID 19, njëkohësisht ato janë transmetuar në ueb faqet zyrtare të komunave përmes kanalit të youtube-s. Paralelisht me kuvendet, aktivitetin e tyre e kanë zhvilluar edhe komitetet obligative, si dhe komitetet e tjera të themeluara. Sipas të dhënave, janë mbajtur 374 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe 323 të Komitetit për Komunitete. Krahas kësaj, 7 komuna kanë mbajtur 39 takime për sektorë të ndryshëm, si dhe 8 komuna kanë mbajtur 111 takime të komiteteve konsultative.

Për nga numri i akteve të kuvendeve, gjatë kësaj periudhe janë miratuar 1802 akte, prej të cilave janë 111 rregullore dhe 1691 vendime. Numri më i madh i rregulloreve është aprovuar në Mitrovicën Jugore, Skenderaj dhe Malisheva, derisa vendime më së shumti kanë aprovuar kuvendet e komunave: Vushtrria dhe Gjilani. Kuvendet e komunave kanë ushtruar rolin e tyre mbikëqyrës ndaj ekzekutivit të komunës. Sipas të dhënave, 32 kryetarë të komunave kanë përmbushur kriterin minimal prej 2 raportimeve brenda vitit para kuvendit. Llogaridhënia e kryetarëve duhet të shtohet në 6 komuna, ashtu që raportimet e tyre të paraqiten në kuvende sipas afateve ligjore të përcaktuara me LVL (Deçan, Mamushë, Istog, Rahovec dhe Graçanicë dhe Klllokot).

Promovimi i transparencës komunale mbetet një nga çështjet kyçe të qeverisjes demokratike. Në këtë drejtim, janë mbajtur 56 takime publike me qytetarë në 30 komuna. Obligimi ligjor për komuna për mbajtjen e së paku 2 takimeve gjithëpërfshirëse me qytetarë nuk është përmbushur në 12 komunat, dhe atë: Mamushë, Istog, Kamenicë dhe Partesh (me nga vetëm 1 takim), si dhe 8 komuna tjera: Mitrovicë e Veriut, Fushë Kosovë, Ranillug, Klllokot, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Novobërdë të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim në këtë periudhë. Sa u përket akteve të aprovuara në 34 komuna rreth 89% të tyre janë publikuar në ueb-faqet e komunave pas aprovimit, kurse komunat: Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut nuk kanë publikuar asnjë vendim të kuvendeve komunale.

Gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore në komuna. Edhe pse jo në masën e duhur, punësimi i grave në nivel lokal është prezent në kuadër të pozitive menaxheriale. Sipas të dhënave të 38 komunave, në pozita menaxheriale janë të sistemuara 1859 gra. Krahas tyre, në administratën dhe kuvendet e 38 komunave, të dhënat tregojnë për 3669 gra të punësuar nga të gjitha komunitetet. Megjithatë, ka nevojë të ngritet vetëdija e përgjithshme institucionale dhe shoqërore, ashtu që të adresohet edhe një nga rekomandimet kryesore të BE-së për përfshirje të grave në

pozita vendimmarrëse. Në 38 komuna janë emëruar vetëm 2 gra nënkryetare dhe në 10 komuna ku duhet të ekzistoj pozita e nënkryetarit për komunitete vetëm 1 grua ushtron këtë pozitë. Krahas kësaj, janë zgjedhur vetëm 6 gra kryesuese të kuvendeve të komunave: Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë, Skenderaj, Shtime, Zveçan. Po ashtu, nga gjithsejtë 377 drejtorë sa janë në 38 komuna, 95 gra janë të emëruara në këto pozita, ndërsa pjesa tjetër ose 282 janë burra. Gratë e përfaqësuara në pozita vendimmarrëse shprehur me përqindje janë 25.2 %, ndërsa burra 74.8 %.

Siguria në bashkësi mbetet përgjegjësi e përbashkët institucionale me qëllim diskutimit dhe parandalimit të rreziqeve ndaj jetës dhe sigurisë së qytetarëve. Kufijtë e mbrojtjes policore nuk mjaftojnë për t'u përballur me fenomenet sociale të shumta që mund të ndodhin në bashkësi, për çfarë kërkohet bashkëpunim dhe bashkërendim i të gjitha mekanizmave, përfshirë: komunat, policinë, shoqërinë civile, qytetarët, mediat, etj. Për këtë arsye, këshillat për siguri në bashkësi janë forume të cilat mund të sjellin ndryshime esenciale në politikat e sigurisë në bashkësi dhe në përcaktimin e prioriteteve në këtë fushë. Kryetarët e komunave janë kujdesur që gjatë vitit 2020 të mbahen 142 takime të KKSBB-ve. Funksionimi normal i këtyre trupave është arritur në 34 komuna, derisa në 4 komuna: Laposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan, dhe Zubin Potok nuk janë themeluar, në përgjithësi gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të aktiviteteve të KKSBB-ve, krahasuar me vitet paraprake kjo si rezultat edhe i pandemisë të COVID 19 në vend.

Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë miratuar 1802 akte, (111 rregullore, 1691 vendime). Nga gjithsej 1802 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1171 akteve, prej te cilave, 1118 akte janë konfirmuar të ligjshme, ndërsa 53 të kundërligjshme. MAPL, ka dërguar në Ministrinë e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë 631 akte, prej te cilave 546 akte janë konfirmuar të ligjshme ndërsa 85 akte janë konstatuara të kundërligjshme. Pra, në parim niveli i përgjithshëm i ligjshmërisë së akteve të komunave për vitin 2020 ka arritur në 92%, ndërsa 8% e akteve janë vlerësuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Shumicën prej tyre, apo 84% e akteve të vlerësuara si të kundërligjshme, komunat i kanë ri-shqyrtuar dhe harmonizuar me ligjin. Nga kjo mund të konstatojmë se, vetëm 17 akte apo 1% e nivelit të përgjithshëm të akteve të miratuara për vitin 2020 konsiderohen si akte të kundërligjshme.

Komunat kanë barrën e tyre të përgjegjësisë në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kritereve kryesore të integritit: a) Politike, b) Ekonomike, c) Standardeve Evropiane. Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2020 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 57% të aktiviteteve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 65% të kritereve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 57% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2020 është 60%.

Gjatë vitit 2020 Kosova sikurse vendet tjera është ballafaquar me pandeminë globale të COVID 19. Masat e ndërmarra nga Qeveria kundër pandemisë COVID-19 si dhe rekomandimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës në vazhdimësi janë zbatuar nga shumica e komunave. Komunat kanë ndërmarr një numër të madh të masave për parandalimin e pandemisë COVID-19 ku në 37 komuna: janë themeluar shtabet emergjente komunale, janë bërë dezinfektimet e gjitha

objekteve publike, janë bërë instalimet e tuneleve dezinfektuese, janë zbatuar masat dhe rekomandimet nga MSH, është ofruar përkujdesje shëndetësore ndaj personave të prekur me COVID 19, është ofruar ndihmë për familjet në nevojë, është bërë aktivizimi i administratorëve të fshatrave, janë ngritur tenda për kontrollë paraprak për personat me simptomat e virusit pandemik, është ofruar kontribut në kompanitë publike me pajisje për mbrojtje nga virus, janë zhvilluar një sërë ligjëratash online me profesionistë të fushave të ndryshme, etj. Ndërsa, 1 komunë (Zveçan) nuk ka ofruar të dhëna.

Për vitin 2020, planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë në vlerë prej 83,116,578.00 €. Krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2019 në vlerë prej 87,000,000.00 €, planifikimi për vitin 2020 ka qenë më i ulët për 3,883,422.00€ apo 4.46%.


FUNKSIONIMI I KOMUNAVE

Kjo pjesë përmbledhë mënyrën e funksionimit të organeve të komunave të Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të cilat rregullojnë kompetencat e nivelit lokal të qeverisjes. Po ashtu, kjo pjesë fokusohet në monitorimin e elementeve kryesore të funksionimit të kuvendeve komunale, përmbajtja e të cilave garanton qëndrueshmërinë e organeve komunale, respektimin e procedurave ligjore, respektimin e ligjshmërisë, efikasitetin, transparencën, bashkëpunimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin.

Kuvendi i Komunës

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i pushtetit lokal dhe njëkohësisht është organ i autorizuar ligjërisht për mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve nga ekzekutivi i komunës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të ushtruar funksionin e tij, kuvendi i komunës duhet të mbledhet rregullisht për të miratuar aktet e nevojshme normative të komunës të cilat kërkojnë me legjislacionin në fuqi dhe atyre që duhet nxjerrë, varësisht nga nevojat e komunës, si dhe për të diskutuar dhe vendosur çështjet me interes të përgjithshëm.

Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar standardet minimale që i referohen mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës për të siguruar konsistencë të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit¹. Duke ju referuar të dhënave nga MAPL, gjatë vitit 2020 kuvendet e komunave kanë mbajtur 517 mbledhje, prej tyre 360 kanë qenë të rregullta, 92 të jashtëzakonshme, 39 solemne dhe 26 urgjente të cilat i kemi paraqitur, si vijon:



Diagrami 1: Numri i mbledhjeve të mbajtura nga kuvendet e komunave në periudhën Janar - Dhjetor 2020.

¹ Ligji Nr. 03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Sipas të dhënave nga grafikoni, me përjashtim të komunës së Prizrenit e cila nuk ka përmbushur kriterin ligjor për të mbajtur së paku 10 mbledhje brenda vitit, komunat tjera kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e mbledhjeve, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 43.2 e ligjit.


Sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun deri në njoftimet e qeverisë rreth shfaqjes së pandemisë. Përkundër gjendjes së krijuar nga pandemia mbledhjet e Kuvendit kanë qenë transparente me ç'rast janë transmetuar direkt përmes ueb faqes së komunave dhe kanaleve të tyre në *youtube*. Edhe gjatë kësaj periudhe kohore puna e kuvendeve të komunave, është monitoruar nga MAPL, përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se komunat në përgjithësi e kanë njoftuar organin mbikëqyrës së bashku me ftesën për mbledhje kanë dërguar edhe materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Monitorimi i punës së kuvendeve është bërë përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje fizike në komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore.

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, komunat kanë kryer obligimin ligjor në raport me MAPL-në si dhe me publikun, duke informuar në vazhdimësi për mbajtjen e mbledhjeve, sipas afatit të përcaktuar ligjor.

Mbarëvajtja e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, gjatë kësaj periudhe në përgjithësi ka qenë konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, mirëpo janë evidentuar disa raste kur një pjesë e anëtarëve të kuvendeve në disa komuna nuk janë njoftuar me kohë për mbajtjen e mbledhjeve (komuna e Kllokotit) si dhe ka pasur raste kur anëtarët e Kuvendit e kanë lëshuar mbledhjen për arsye të ndryshme si komunat: Prizren dhe Istog. Në rastin e komunës së Istogut, arsyeja e ndërprerjes së mbledhjes ka qenë largimi i fotografisë së Presidentit të Republikës së Kosovës nga salla e kuvendit të Komunës. Ndërsa komuna e Prizrenit ka ndërprerë mbledhjen për shkak të mungesës së kuorumit si rezultat i mos zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit.

Komitetet e Kuvendit të Komunës

Me legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme dhe komitetet e tjera për të mbështetur punën e tyre. Këto komitete janë themeluar dhe kanë funksionuar në të gjitha komunat. Marrë parasysh numrin e takimeve, Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të jetë më aktiv në komunën e Zubin Potokut. Në anën tjetër, Komiteti për Komunitete ka pasur intensitet shumë të ulët të takimeve në komunat: Prizren, Prishtinë, Gjilani, Zveçan dhe Zubin Potok. Sipas të dhënave, në periudhën Janar – Dhjetor 2020, gjithsej janë mbajtur 697 takime. Komiteti për Politikë dhe Financa kanë mbajtur 374 takime, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 323 takime, si vijon:



Diagrami 2: Numri i mbledhjeve të Komiteteve të Përhershme në periudhën Janar - Dhjetor 2020.

Duke marrë parasysh se Komiteti për Politikë dhe Financa është organ i përhershëm i Kuvendit të Komunës, përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, propozim-vendimeve, projekt-rregulloreve dhe çështjeve të buxhetit, rrjedhimisht puna e këtij komiteti përfaqëson edhe rekomandimet për kuvendin e komunës. Mbi bazën e kësaj, ky komitet takimet duhet t'i mbajë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, duke marrë parasysh funksionet e përcaktuara edhe me Rregulloret e Punës së Kuvendeve të Komunave.

Komiteti për Komunitete, është komiteti i dytë i përhershëm i kuvendit të komunës, detyrë e të cilit është shqyrtimi i përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, shqyrtimi i të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se respektohen plotësisht të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Ai gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për të avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komitetet ndihmëse dhe Komitetet Konsultative


Kuvendi i komunës mund të themeloj komitete të tjera profesionale nëse e sheh të nevojshme dhe të përshtatshme për të përmbushur përgjegjësitë e veta për sektor specifik si: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Për të rritur pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesuara në procesin e vendimmarrjes komunale, kuvendi i komunës themelon edhe komitete konsultative brenda sektorëve përkatës qeverisës. Bazuar në nenin 73, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe UA (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurat e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, Kuvendi i Komunës, është i obliguar të themeloj edhe komitetet konsultative, me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Sipas të dhënave gjatë vitit 2020, vetëm 8 komuna kanë

mbajtur 111 takime të Komiteteve Konsultative, si vijon: Mitrovicë Jugore (36 takime), Pejë (18 takime), Gjilan (2 takime), Klinë (3 takime), Istog (12 takime), Podujevë (12 takime), Kaçanik (5 takime) dhe Han i Elezit (23 takime). Fushat e mbuluara nga këto komitete janë: planifikimi hapësinor (13 takime), arsimi (10 takime), zhvillimi ekonomik (24 takime), shëndetësi dhe mirëqenie sociale (10 takime), shërbime publike (16 takime), personat me aftësi të kufizuara (23 takime), çështje emergjente (1 takim), bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit (8 takime) dhe arsim, kulturë, rini dhe sport (6 takime).

Sa i përket Komiteteve tjera ndihmëse, në këtë periudhë 7 komuna kanë mbajtur 39 takime. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi takimeve të Komitetit për Shëndetësi. Komuna të cilat kanë mbajtur takime të Komiteteve tjera ndihmëse janë: Fushë Kosovë (7 takime), Gjilan (16 takime), Kaçanik (6 takime), Gjakovë (2 takime), Ranillug (3 takime), Graçanicë (4 takime) dhe Junik (1 takim). Fushat më të mbuluara nga këto komitete janë: shëndetësi dhe mirëqenie sociale (3), arsim, kulturë, rini dhe sport (7), planifikim hapësinor (4), bujqësi (3), zhvillim ekonomik (3), ndërmjetësim (1), shërbime publike (12), persona me nevoja të veçanta (4), mbrojtje dhe shpëtim (1) dhe barazi gjinore (1).

Aktet e kuvendeve të komunave

Kuvendi Komunës ka në kompetencë miratimin e vendimeve dhe rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat në nivel lokal. Kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e Punës, merr vendime, nxjerr rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, miraton çështje financiare, zgjedh kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe nënkryetarët (e komuniteteve), si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Gjatë periudhës raportuese shumica e kuvendeve të komunave kanë qenë aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Për nga numri, janë miratuar gjithsej 1802 akte komunale, prej të cilave 111 rregullore dhe 1691 vendime.




Diagrami 3: Numri i akteve të miratuara në Kuvendet e Komunave, Janar-Dhjetor 2020.

Pasqyra e të dhënave për aktet e miratuara tregojnë se numrin më të madh të Rregulloreve e ka miratuar kuvendi i komunës së Mitrovicës së Jugut (108), kuvendi i komunës së Skenderajt (101) dhe kuvendi i komunës së Malishevës (97), derisa numrin më të madh të vendimeve e kanë miratuar kuvendet e komunave: Vushtrri (9) dhe Gjilan (8), komunat tjera më pak për shkak edhe të pandemisë globale të COVID 19. Komunat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore, që rregullojnë fusha të ndryshme të marrëdhënieve juridike, mirëpo më kryesoret janë: miratimi i akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, etj. Komunat me pasive në këtë drejtim kanë qenë komunat: Zubin Potok, Zveçan, Dragash dhe Mamushë.

Procesi i administrimit të kërkesave të komunave për kthimin e pronës së AKP-së - Gjatë kësaj periudhe, komunat kanë parashtruar një numër të madh të kërkesave ndaj qeverisë qendrore, për të mundësuar bartjen (kthimin) e pronave të paluajtshme të cilat janë në menaxhim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, si dhe pronave të cilat menaxhohen nga institucionet e nivelit qendror. Numri i kërkesave të pranura nga komunat në Ministrinë e Pushtetit Lokal për vitin 2018 ka qenë afër 40, në vitin 2019 ky numër ka qenë 19, përderisa në vitin 2020 ky numër është 20 kërkesa, të proceduara nga komunat: Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Kamenicë, Lipan (2), Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Pejë, Prizren (2), Ranillug, Skenderaj, Vushtrri, Zveçan (2), Skenderaj, Rahovec dhe Prishtinë.

Transparenca dhe llogaridhënia komunale

Raportimi i kryetarit - Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar obligimin e kryetarit të komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Në bazë të paragrafit j) të nenit 58 të këtij ligji, kryetari i komunës është i obliguar të raportoj para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i Komunës. Të dhënat flasin se gjatë vitit 2020 numri i raportimeve të kryetarëve të Komunave para kuvendit ka qenë 92, të cilat janë paraqitur, si vijon:




Diagrami 4: Numri i raportimeve të kryetarëve para kuvendeve të komunave.

Diagrami i lartcekur pasqyron të dhënat se në 32 komuna kryetarët e komunave kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor për të raportuar para kuvendit të komunës, madje në 15 komuna: Prizren, Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Hani i Elezit, Suharekë, Gjakovë, Kamenicë, Skenderaj, Obiliq, Viti, Malishevë, Fushë Kosovë, Shtime, Kaçanik dhe Podujevë, kryetarët kanë raportuar më shumë se dy herë. Në 5 komuna, kryetarët nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor për raportim të paktën 2 herë brenda vitit, siç është e përcaktuar në LVL, komunat: Deçan, Mamushë, Istog, Rahovec dhe Graçanicë, pasi kryetarët e komunave kanë raportuar vetëm nga 1 herë, ndërsa në Komunën e Kllokotit, kryetari i komunës nuk ka raportuar asnjëherë në këtë periudhë.

Forma të tjera të llogaridhënies janë edhe përmes pyetjeve të drejtpërdrejta dhe me shkrim të parashtruara nga anëtarësia e kuvendit ndaj ekzekutivit. Për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet kuvendit dhe ekzekutivit të komunës, është i nevojshëm shtimi i prezencës së rregullt të kryetarëve dhe drejtorëve në mbledhjet e kuvendeve të tyre. Një komunikim i vazhdueshëm i të dy organeve i kontribuon demokracisë lokale, rritë cilësinë e vendimmarrjes dhe ligjshmërisë, zgjeron rrethin e aktorëve përgjegjës për hartimin e politikave të zbatueshme me interes të përgjithshëm, si dhe ndërton segmente të llogaridhënies brenda administratës komunale.

Takimet publike me qytetarë - Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion standarde të përcaktuara me udhëzimin administrativ Nr. 06/2018 për standardet minimale për konsultim publike në komuna, dhe atë përmes: takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik, përfshirjes aktive të qytetarëve, grupeve të interesit, tryezave të përbashkëta, përdorimit të sistemeve elektronike të informacionit, si dhe metoda të tjera me të cilën transparenca do të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.



Diagrami 5: Numri i takimeve publike me qytetarë në vitin 2020.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale çdo komunë mbanë së paku dy herë në vit takime publike në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë. Njëra nga mbledhjet duhet të mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Në takime të tilla përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të ngritin çështje të ndryshme dhe të japin propozime para organeve komunale. Në vitin 2020, organizimi i takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë në komuna ka qenë si në vijim:

Diagrami i mësipërm tregon se në 30 komuna janë mbajtur 56 takime me qytetarë. Prej tyre, 26 komuna kanë organizuar nga 2 takime publike me qytetarë, kurse 4 komuna: Mamushë, Istog, Kamenicë dhe Partesh kanë organizuar vetëm nga 1 takim, derisa 8 komuna: Mitrovicë e veriut, Fushë Kosovë, Ranillug, Kllokot, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe Novobërdë nuk kanë mbajtur asnjë takim në këtë periudhë.

Përveç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur edhe takime të tjera me qytetarë në lokacione më të vogla, lagje, fshatra dhe vendbanime të tjera. Forma të tilla të organizimit, janë bërë me rastin e diskutimit të projekt-rregulloreve, planeve dhe çështjeve buxhetore, të cilat qytetarëve u kanë mundësuar ofrimin e rekomandimeve, propozimeve dhe kërkesave të tyre. Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit në 31 komuna janë mbajtur 162 dëgjime publike, kurse në 7 komuna: Novobërdë, Zubin Potok, Obiliq, Gjilan, Prishtinë, Kllokot dhe Kamenicë nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik.

Mbajtja e takimeve publike dhe formave të tjera të konsultimit publik duhet të jetë proces i vazhdueshëm në të gjitha fazat e politikbërjes në komunë. Lidhur me këtë, janë hartuar edhe rregullat për standardet minimale të konsultimit publik për komuna, të cilat kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2019 dhe një pjesë e konsiderueshme e komunave vazhdojnë që t'i zbatojnë.

Ueb-faqet zyrtare të komunave - Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2015 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. Përderisa në vitin 2018 është realizuar projekti për ridizajnimin e ueb-faqeve të të gjitha komunave, në vitin 2019 ndryshimet e tyre kanë sjellë integrimin e sistemit të intranetit në ueb-faqet e komunave, ku qytetarët mund të adresojnë kërkesat për pajisje me dokumentet e gjendjes civile. Gjithashtu, në këtë drejtim është krijuar qasja në gjurmimin e lejeve të ndërtimit, paraqitjes së kërkesave të qytetarëve në fushën e sigurisë në bashkësi, si dhe transmetimi online i mbledhjeve të kuvendeve të komunave.


Struktura e ueb-faqeve mundëson qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në të gjitha dokumentet relevante të destinuara për publikim. Përditësimi i të dhënave të komunave është bërë në vazhdimësi, edhe pse ka vend për përmirësim sidomos në publikimin e akteve normative në gjuhët zyrtare. Sipas të dhënave, gjatë kësaj periudhe nga 38 ueb faqe të komunave, në 29 prej tyre janë publikuar gjithsej 301 procesverbale të mbledhjeve të kuvendeve të komunave nga gjithsej 517 mbledhje të mbajtura, prej tyre 360 të rregullta, 92 të jashtëzakonshme, 39 solemne, 26 urgjente. Shkalla e publikimit të tyre është 76%. Kurse, 9 komuna të tjera: Gjilan, Junik, Novobërdë, Prizren, Shtërpçë, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, nuk kanë publikuar asnjë nga procesverbalet nga mbledhjet e kuvendeve të komunave në këtë periudhë.

Nga totali i 1691 vendimeve të aprovuara në kuvendet e komunave, komunat kanë publikuar 1464 vendime. Pra 34 komuna ose 89% e komunave kanë publikuar 1464 vendime të kuvendit komunal, ndërsa 4 komuna ose 11% e tyre nuk kanë publikuar asnjë vendim të kuvendeve komunale. Pra, komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë vendim të kuvendeve komunale janë: Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut. Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë aprovuar 111 rregullore ndërsa janë publikuar vetëm 86 rregullore të kuvendeve komunale. Pra, nga 38 komuna të Republikës së Kosovës, 28 komuna ose 74% e tyre kanë publikuar rregulloret e kuvendit, ndërsa 10 komuna ose 26% e tyre nuk kanë publikuar asnjë rregullore. Komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë rregullore janë Istog, Kamenicë, Novobërdë, Klllokot, Prishtinë, Shtërpçë, Zveçan, Leposaviq, Mitrovica e Veriut dhe Dragash.

Sa i përket transparencës buxhetore, komunat në përgjithësi qëndrojnë mirë. Nga totali 38 i komunave, 28 komuna ose 74% e tyre kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2020 ndërsa 10 komuna ose 26% e tyre nuk kanë publikuar planin e buxhetit për vitin 2020. Komunat të cilat nuk kanë publikuar planin e buxhetit janë: Gllogoc, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtime, Viti, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut. Sa i përket transparencës në prokurim, 27 komuna ose 71% e komunave kanë publikuar planin e prokurimit ndërsa 11 komuna ose 29% e tyre nuk kanë publikuar planin e prokurimit komunat: Fushë Kosovë, Kamenicë, Kaçanik, Klllokot, Malishevë, Partesh, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe Mitrovicë e Veriut.

Siguria në Bashkësi


Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB është organ këshillëdhënës ndërsektorial, përgjegjës për çështjet e sigurisë në nivel lokal. Funksionimi i këshillave për siguri në bashkësi rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Për shkak të normimit të standardeve të funksionimit të tyre, ka pasur ngritje të vetëdijes institucionale për rëndësinë e KKSBB-ve, duke bërë që angazhimi i komunave të fokusohet edhe në çështjet e përgjithshme të sigurisë, përfshirë këtu: vetëdijesimin e qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2020 janë mbajtur gjithsej 142 takime të KKSBB-ve. Në vijim është paraqitur figura e takimeve të KKSBB-ve sipas komunave:



Diagrami 6: Numri i takimeve të KKSBB-ve sipas komunave, Janar-Dhjetor 2020.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se në mbajtjen e takimeve të KKSBB-ve më aktive kanë qenë komunat: Hani i Elezit, Kllokot dhe Glllogoc. Krahasuar me kriterin minimal të kërkuar sipas udhëzimit përkatës administrativ, 13 komuna kanë përmbushur obligimin prej 6 apo më shumë takimeve, derisa 21 komuna të tjera renditen nën standardin minimal të kërkuar (Prizren, Deçan, Junik, Mamushë, Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Istog, Gjiilan, Gjakovë, Kamenicë, Vushtrri, Klinë, Obiliq, Malishevë, Fushë Kosovë, Ranillug, Shtërpcë, Partesh, Graçanicë, Novobërdë dhe Podujevë), si dhe 4 komuna: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok ende nuk e kanë të themeluar Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.

Problemet më të shpeshta të cilat janë trajtuar gjatë kësaj periudhe të raportimit, si dhe iniciativat për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2020, janë: menaxhimi i situatës me pandeminë COVID-19, kastrimi i qenve endacak, vendosja e kamerave në qytet dhe në shkolla apo afër shkollave, ndriçimi publik, hartimi i planit operativ në koordinim me Policinë e Kosovës për parandalimin e zjarrëvënies, iniciativa për vendosjen e shenjave të komunikacionit, rregullimi dhe vënia në funksion e sistemit të alarmit publik të banorëve të komunës, kontrollimi i zonave të dyshimta për mjete shpërthyes, menaxhimi i mbeturinave, etj.



Në krahasim me vitet paraprake, gjatë vitit 2020 shihet se ka pasur rënie të aktiviteteve të KKSBB-ve, kjo edhe si rezultat i pandemisë globale të COVID 19. Sipas të dhënave, në vitin 2016 janë mbajtur 177 takime të KKSBB-së, në 2017 gjithsej 119 takime (për shkak të vitit zgjedhor), në 2018 janë mbajtur 184 takime, në vitin 2019 janë mbajtur 186 takime, si dhe në vitin 2020 janë mbajtur gjithsej 142 takime.

MAPL, prej vitit 2019, në kuadër të zhvillimit të sistemeve të informacionit ka krijuar edhe një qasje të veçantë në ueb-faqet e komunave, që i mundëson publikut raportimin online të problemeve të sigurisë, parashtrimin e pyetjeve dhe kërkesave lidhur me sigurinë, si dhe marrjen e përgjigjeve nga autoritetet komunale. Ky sistem duhet të vazhdohet me aplikim nga zyrtarët përgjegjës të komunave, në mënyrë informatat të cilat raportohen nga qytetarët të mund të administrohen nga institucionet përgjegjëse në të mirë të përmirësimit të gjendjes së përgjithshme të sigurisë në bashkësi.

Grafikoni 1: Krahasimi i numrit të takimeve të KKSBB-ve sipas viteve të fundit.

Krahas KKSBB-vë, në 27 komuna janë funksionale edhe Ekipet Vepruese për Siguri (EVS). Gjatë kësaj periudhe nga 27 komuna sa janë funksionale këto forume, vetëm 14 komuna kanë mbajtur 31 takime. Këto forume duhet të themelohen në 11 komuna të tjera, si: Novobërdë, Mamushë, Deçan, Klinë, Skenderaj Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Kllokot dhe Ranillug. Sa i përket, Këshillave Lokale për Siguri Publike (KLSP-ve), ato janë funksionale në 28 komuna, ndërsa funksionalizmi i tyre ende nuk është bërë në 8 komuna: Novobërdë, Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Junik, Shtërpçë dhe Ranillug, si dhe 2 komuna: Hani i Elezit dhe Mitrovicë Jugore nuk kanë ofruar të dhëna. Prej 28 komunave sa janë funksionale këto forume, vetëm 22 komuna kanë mbajtur gjithsej 82 takime në këtë periudhë.


Kuvendet e komunave dhe kryetarët e tyre, duhet të fokusohen më tepër rreth prioriteteve të sigurisë, e posaçërisht për funksionalizimin e KKSBB-së, si organ kryesor për përfaqësimin e nevojave të sigurisë së qytetarëve. Gjithashtu, komunat duhet shtuar numrin e takimeve të këtij Këshilli së paku deri në pragun minimal të përcaktuar me Udhëzim Administrativ.

Këshillat e fshatrave janë themeluar dhe janë funksionale në 24 komuna, ndërsa në 11 komuna: Mamushë, Ranillug, Dragash, Klinë, Junik, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Istog dhe Fushë Kosovë nuk janë themeluar. Si dhe në 3 komuna: Podujevë, Partesh dhe Prishtinë janë themeluar por nuk janë funksional.

Mbikëqyrja e komunave

Mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së komunave është kompetencë e autoriteteve qendrore varësisht nga fushat e lëndës në të cilën ushtrohet ky funksion. Parimisht, MAPL është autoriteti mbikëqyrës i komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar ato². Procesi i shqyrtimit administrativ të akteve komunale është rregulluar më detajisht me Rregulloren (QRK) NR-10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Gjatë kësaj periudhe, janar-dhjetor 2020, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1802 akte, prej të cilave 111 rregullore dhe 1691 vendime. Nga gjithsej 1802 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, MAPL ka shqyrtuar ligjshmërinë e 1171 akte, ku 1118 akte janë konfirmuar të ligjshme, dhe 53 akte janë konstatuar të kundërligjshme. Ndërsa, 631 akte janë dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë në ministrin e linjës (MEA, MSH, MBPZHR, MASH, MF, MKRS, MPB, MI,MTI, AEE, ABGJ, MPMS, MD), konform mandatit të tyre të përcaktuar ligjor. Në vijim, është paraqitur figura me të dhënat për procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve komunale:




Diagrami 7: Procesi i shqyrtimit administrativ.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave, të cilat janë paraqitur edhe në grafikonin e paraqitur më lartë, shohim se: Nga gjithsej 1171 akte të cilat janë shqyrtuara nga Ministria e Pushtetit Lokal gjatë viti 2020, prej tyre 1118 akte të komunave janë vlerësuar dhe konfirmuara si të ligjshme, ndërsa 53 akte tjera janë vlerësuar dhe kthyer komunave në

² Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kreu X, Nenet 75 dhe 76.

rishqyrtim si akte të cilat nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, vërejmë se nga gjithsej 53 kërkesa për rishqyrtim, vetëm për 47 akte prej tyre komunat pas marrjes së kërkesës për rishqyrtim I kanë rishqyrtuar dhe harmonizuar sipas kërkesës së MAPL dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, ndërsa për 6 akte tjera komunat nuk kanë ndërmarrë veprimet e caktuara ligjore për ri-shqyrtimin e tyre dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me rastet e akteve të cilat Ministria e Pushtetit Lokal ka konstatuar se komunat nuk kanë ndërmarrë veprimet ligjore për ri-shqyrtim dhe harmonizim, MAPL ka kompletuar lëndën përkatëse për kundërshtim gjyqësor dhe ka përcjellë në Ministri të Drejtësisë për tu proceduar në gjykatë. Komunat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar fare aktet e të cilat janë përcjellë në Ministrinë e drejtësisë janë: Kamenica (3 akte), Prizreni(2 akte), Prishtina(1 akt). Lidhur me këtë, nga këto akte, Komuna e Prishtinës e ka rishqyrtuar një akt por nuk e ka harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së, ndërsa Kamenica dhe Prizreni nuk i kanë ri-shqyrtuar fare. Për nga natyra e llojit të akteve të komunave që janë kthyer në rishqyrtim dominojnë: ato të cilat kanë të bëjnë më dhënie e pronës komunale në shfrytëzim, statutet e komunës, rregulloret komunale për transparencë, vendime për caktimin e lokacioneve për ndërtimin, zëvendësimin e anëtarëve në komitetet e përhershme të kuvendit e të cilat nuk janë në harmoni më ligjin për barazi gjinore, etj.,




Diagrami 8: *Trendi i miratimit dhe shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL*

Nga diagrami I më sipër mund të vërejmë një rënie të intensitetit të punës së Kuvendeve të Komunave në nxjerrjen e akteve komunale në krahasim me dy vitet e kaluara për gati 10% më pak. Në anën tjetër kemi rritje të numrit të akteve të komunave që i janë nënshtruar shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Pushtetit Lokale për afro 10% me shumë. Ndërsa, trendi i shkeljeve ligjore dhe inicimit të procedurave për gjykatë përmes Ministrisë së Drejtësisë është pothuajse i njëjtte me dy vitet e kaluara, i ulët por evident.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve të komunave nga ministritë e linjës. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit dhe komunikimi zyrtar me ministritë e linjës, ashtu siç janë paraqitur edhe në grafikonin e paraqitur më lartë, shohim se: Nga gjithsejtë 631 akte të komunave të cilat janë vlerësuar dhe shqyrtuara nga ministritë e linjës gjatë vitit 2020, prej tyre 546 akte janë vlerësuar dhe konfirmuara si të ligjshme, ndërsa 85 akte tjera janë vlerësuar dhe janë konstatuara të kundërligjshme. Për të gjitha shkeljet e konstatuara, nga ministritë e linjës, Ministria e Pushtetit Lokal ka dërguar në komunitat përkatëse kërkesat për rishqyrtim dhe harmonizim të akteve komunale tek organet e kompetente.


Nga gjithsejtë 85 kërkesa për ri-shqyrtim, vetëm 68 akte prej tyre janë ri-shqyrtuar dhe harmonizuar me legjislacionin përkatës sipas kërkesës së ministrisë përkatëse për mbikëqyrje, ndërsa për 17 akte tjera komunitat nuk kanë ndërmarrë veprimet e caktuara ligjore për ri-shqyrtimin e tyre dhe harmonizimin me legjislacionin në fuqi. Prej tyre, 13 akte të komunave nuk janë proceduar fare për ri-shqyrtim në Kuvendin e Komunës (Gjakova 3, Prizreni 1, Deçani 2, Parteshi 1, Prishtina 1, Klina 2, Ranillug 1 dhe Malisheva 2), ndërsa 2 akte janë ri-shqyrtuar por nuk janë harmonizuar sipas kërkesës (Klina 1 dhe Pareshe 1), si dhe komunitat Junik (1) dhe Hani Elezit (1) aktet e tyre i kanë ri-shqyrtuar dhe harmonizuar pas periudhës raportuese, në vitin 2021. Lidhur me rastet e akteve për të cilat ministria e linjës ka konstatuar se komunitat nuk kanë ndërmarrë veprimet e caktuara ligjore për rishqyrtim dhe harmonizimin për mos-përputhje të aktit komunal me legjislacionin në fuqi, MAPL ka kompletuar lëndën përkatëse për kundërshtim gjyqësor dhe ka përcjellë në Ministri të Drejtësisë për tu proceduar në gjykatë për 10 akte të komunave, ndërsa edhe 6 akte tjera ishin brenda afatit ligjor për r-shqyrtim. Komunitat të cilat nuk i kanë rishqyrtuar fare aktet e të cilat janë përcjellë në Ministrinë e drejtësisë janë : Gjakova (3), Prizreni(1), Deçan(2), Partesh(2), Prishtina(1), Klina(1). Lidhur me këtë, nga këto akte, Komuna e Parteshit dhe Komuna e Klinës edhe pse e kanë rishqyrtuar nga një akt, të njëjtat nuk janë harmonizuar sipas kërkesës për ri-shqyrtim.

Për nga natyra e llojit të akteve të kthyera nga Ministritë e linjës kryesisht kanë të bëjnë me: hartimin e planeve zhvillimore komunale, miratimin e hartave zonale, miratimin e rregulloreve për tarifa dhe gjoba komunale, pastaj akte që kanë të bëjnë me subvencionimin e energjisë, vendime për caktimin e lokacioneve për ndërtim, rregullore për grumbullimin e mbeturinave, ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, etj.,.



Në këtë diagram mund të shohim një rënie të theksuar të numrit të akteve që janë përcjell dhe janë shqyrtuar nga ministritë e linjës për komunat në vitin 2020 në krahasim me dy vitet e kaluara ku kemi rënie afër 50% të lëndëve. Ndërsa, niveli i kërkesave për ri-shqyrtim të ministrive përkatëse për aktet e komunave në raport me numrin e akteve që janë shqyrtuar është përafërsisht i njëjtë me nivelin e viteve paraprake.

Parimisht, niveli i përgjithshëm i ligjshmërisë së akteve të komunave për vitin 2020 ka arritur në 92%, ndërsa 8% e akteve janë vlerësuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Shumicën prej tyre, apo 84% e akteve të vlerësuar si të kundërligjshme, komunat i kanë ri-shqyrtuar dhe harmonizuar me ligjin. Nga kjo mund të konstatojmë se, vetëm 16 akte apo më pak se 1% e nivelit të përgjithshëm të akteve të miratuara për vitin 2020 konsiderohen si akte të kundërligjshme për çka janë iniciuar procedurat e kundërshtimit në gjykata për 7 komuna dhe atë: Kamenica, Prizreni dhe Gjakova për nga 3 akte, Prishtina, Deçani dhe Parteshi për nga 2 akte dhe komuna e Klinës për 1 akt.



Diagrami 7.1. Rastet e inicimit të procedurave në gjykatë

TABELA 1. Paraqitja tabelore e komunave të cilat i kanë ri-shqyrtuar por nuk i kanë harmonizuar aktet dhe ato të cilat nuk i kanë kaluar fare nëpër proces të ri-shqyrtimit nga Kuvendi i Komunës gjatë vitit 2020


KOMUNA	NR. KËRKESAVE PËR RISHQYRTIM	AUTORITETI MBIKËQYRËS	RI- SHQYRTIMI AKTIT	HARMONIZIMI I AKTIT KOMUNAL	ADRESIMI NË MD (PËR GJYKATË)
KAMENICA	3	MAPL	JO	JO	PO
PRIZRENI	3	MAPL (2)	JO	JO	PO
		ML (1)	JO	JO	PO
GJAKOVA	3	ML	JO	JO	PO
PRISHTINA	2	MAPL	JO	JO	PO
		ML	PO	JO	PO
DEÇANI	2	ML	JO	JO	PO
PARTESHI	2	ML	JO	JO	PO
		ML	PO	JO	PO
KLINA	3	ML (2)	JO	JO	JO
		ML (1)	PO	JO	PO
RANILLUG	1	ML	JO	JO	JO
MALISHEVA	2	ML	JO	JO	JO
HANI ELEZIT ³	1	ML	JO	JO	JO
JUNIK ⁴	1	ML	JO	JO	JO

³ Komuna e Hani Elezit aktin e ka ri-shqyrtuar në vitin 2021.⁴ Komuna e Junikut aktin e ka ri-shqyrtuar në vitin 2021.

AGJENDA EVROPIANE⁵

Zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim Asociim është një ndër prioritetet më të rëndësishëm të Republikës së Kosovës e cila është nënshkruar nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian dhe ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016 ka aprovuar Programin Kombëtar për zbatimin e MSA-së, dokument i cili i obligon institucionet shtetërore t'i kryejnë të gjitha obligimet e kërkuara në këtë proces. Komunat si nivel i veçantë i institucioneve të administratës shtetërore kanë përgjegjësin e tyre në raport me përmbushjen e masave të kërkuara në fushën e agjendës evropiane. Në këtë drejtim Ministria e Pushtetit Lokal, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në këtë fushë me nivelin lokal të qeverisjes, gjatë vitit 2020 ka ndërmarrë një sërë veprimesh për adresimin dhe zbatimin e obligimeve nga agjenda evropiane, të cilat janë paraqitur në këtë raport. Duke pasur parasysh zhvillimin e pandemisë COVID-19 dhe kontributin e komunave në këtë fazë, raporti përfshinë edhe aktivitetet e komunave në menaxhimin e pandemisë globale të COVID-19, si vijon:

- Programi i komunave në këtë fushë është strukturuar në bazë të 3 kriterëve kryesore të integritimit: a) Kriteret Politike, b) Kriteret Ekonomike dhe c) Standardet Evropiane.
- Komunat kanë ofruar informatat në këtë aspekt duke u bazuar në planet individuale të hartuara nga MAPL, të cilat përfshijnë obligimet më kuadër të: Programit Kombëtar të Zbatimit të MSA-së sfidave të qeverisjes lokale të identifikuara nga Raporti i Vendit dhe dokumentet e tjera relevante.
- Bazuar në të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2020 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 57% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 65% të kriterëve dhe në fushën e standardeve evropiane ato kanë realizuar 57% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2020 është 60%, si vijon:



Diagrami 10: Përmbushja e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane.


⁵ Të dhënat nga pjesa e Agjendës Evropiane janë bazuara në raportet individuale të vet komunave në MPL.

Kriteret politike

Stabiliteti i institucioneve në qeverisjen demokratike, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve jo shumicë, është njëri ndër kriteret që duhet përmbushur në raport me agjendën e integrimin evropian. Përmbushja e kriterëve politike është obligim i cili duhet përmbushur nga Kosova si vend kandidat potencial për anëtarësim në BE. Në këtë pjesë të raportit janë përfshirë të dhënat për aktivitetet e komunave në fushën e kriterëve politike, me fokus: fuqizimin e administratës publike lokale, bashkëpunimin me shoqërinë civile, luftën kundër terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut dhe komuniteteve jo shumicë, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat pronësore, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe fushat e tjera të rëndësishme.

Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Gjatë vitit 2020 janë ndërmarrë aktivitete të shumta për sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën e pushtetit lokal, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, ofrimin e këtyre shërbimeve me kosto sa më të ulët dhe në kohë reale, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, promovimin e qeverisjes elektronike, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët.

Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, komunat kanë hartuar Programin e Trajnimeve dhe bazën e të dhënave të trajnimeve. Programi i trajnimeve është hartuar në 32 komuna, me përjashtim të 6 komunave: Obiliq, Ranillug, Prishtinë, Podujevë, Shtërpçë dhe Mitrovicë e Veriut, të cilat nuk kanë përmbushur këtë obligim. Ndërsa, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave publike në fushën e administratës, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i komunave kanë hartuar Strategjinë për Komunikim me Publikun.



Diagrami 11: *Programi i trajnimeve dhe strategjia për komunikim me publikun.*

Nga 38 komuna raportuese 14 komuna e kanë hartuar këtë strategji, kurse 24 komuna të tjera: Obiliq, Shtime, Ferizaj, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Prizren, Viti, Mitrovicë Jugore, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Leposaviq, Fushë Kosovë, Gjilan, Lipjan, Junik dhe Shtërpçë ende nuk e kanë hartuar.

Një çështje substanciale e gjithëpërfshirjes së qytetarëve në procesin e hartimit të politikave publike në nivel lokal, janë edhe konsultimet publike. Sipas të dhënave nga komunat, janë 34 komuna të cilat kanë ndërmarrë veprime konkrete që qytetarët të përfshihen në konsultime publike, përmes: thirrjeve publike, shpërndarjes së fletushkave, fushatave sensibilizuese, zgjerimit të rrjetit të informimit publik, hartimit të planit për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultime publike etj. Ndërsa 4 komuna: Istog, Shtime, Mamushë dhe Fushë Kosovë nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2020 një progres i konsiderueshëm është bërë edhe në katër komunat e veriut të Kosovës, ku janë themeluar drejtoritë dhe janë emëruar drejtorët e drejtorive komunale. Në anën tjetër, vetëm 1 komunë (Zubin Potok) ka themeluar qendrat për shërbim të qytetarëve, deri sa funksionalizimi i sistemit të intranetit në kuadër të shërbimeve administrative është ngritur në 3 komuna (Zubin Potok, Leposaviq dhe Mitrovicë Veriore).

Gjatë kësaj periudhe, komunat kanë ndërmarrë edhe veprime konkrete që komunitetet jo shumicë të përfshihen në administratën publike, përmes: zbatimit të ligjeve në fuqi lidhur me të drejtat për punësim të komuniteteve jo shumicë, inkurajimit të tyre për përfshirje me anë të fushatave vetëdijësuese, si dhe fuqizimit të rolit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim. Numri i të punësuarve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në institucionet publike lokale sipas të dhënave të 32 komunave është afër 1191 me përjashtim të 4 komunave: Hani Elezi, Kaçanik, Junik dhe Glllogoc të cilat kanë raportuar që nuk kanë të punësuar nga komunitetit jo shumicë. Krahas tyre 2 komuna: Obiliq dhe Mitrovicë e Veriut nuk kanë ofruar të dhëna. Rritja e përgjegjësisë së qeverisjes lokale karshi kërkesave/rekomandimeve nga Avokati i Popullit për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për qeverisjen lokale ka qenë një ndër prioritetet e vitit 2020. Ndaj, nga 38 komuna vetëm 13 komuna: Gjakovë, Novobërdë, Vushtrri, Malishevë, Gjilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Viti, Kamenicë, Glllogoc, Junik dhe Mitrovicë Veriore kanë pranuar 39 kërkesa/rekomandime, prej tyre 19 kërkesa ose 49% janë kthyer pozitive dhe 20 ose 51% kërkesa gjenden në proces të shqyrtimit.

Komunat kanë ofruar bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile. Një rrjet i gjerë i organizatave jo-qeveritare që veprojnë në vend përcjellin dhe angazhohen në projekte të cilat synojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve. Nga të dhënat e prezantuara, shumica e komunave kanë ofruar mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve. Numri i OJQ-ve të përkrahura në 30 komuna është 1138 projekte në vlerë prej 17,799,274.43 euro, ndërsa në 8 komuna: Mamushë, Ferizaj, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Deçan dhe Shtërpçë nuk kanë ndarë buxhet për përkrahjen e organizatave të shoqërisë civile. Gjithashtu, transparenca e publikimit të OJQ-ve përfituese, përkatësisht publikimi i mjeteve, kritereve dhe OJQ-të përfituese në ueb faqet e komunave është bërë në 24 komuna të cilat kanë përkrahur organizatat e

shoqërisë civile, ndërsa 6 komuna tjera: Obiliq, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë dhe Kamenicë nuk i kanë publikuar këto të dhëna.

Transparenca e administratës komunale ka qenë një ndër prioritetet e vitit 2020 dhe si e tillë është monitoruar në vazhdimësi nga niveli qendror. Janë bërë ndryshime në pakon ligjore për transparencë në komuna, si dhe në përmirësimin e sistemeve elektronike të informacionit. Ueb faqet e komunave ofrojnë informata të shumta, ato mundësojnë edhe aplikimin online për t'u pajisur me dokumentet e gjendjes civile, aplikimin online për leje ndërtimore, si dhe parashtrimin e njoftimeve dhe kërkesave për sigurinë në bashkësi.

Zbatimi i strategjisë nacionale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe strategjisë kundër terrorizmit është zgjeruar edhe në nivelin lokal të administratës. Komunitetet kanë ndërmarrë veprime konkrete për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpije në ekstremizëm të dhunshëm. Fushata të tilla janë organizuar në 13 komuna, përmes aktiviteteve si në vijim: fushata vetëdijësuese, aktivitete në terren, takime të rregullta me anëtarët e KKS-së, takime me përfaqësues të komuniteteve fetare, etj. Në anën tjetër, 25 komuna: Prizren, Prishtinë, Viti, Podujevë, Istog, Klllokot, Zveçan, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Fushë Kosovë, Lipjan, Malishevë, Gjakovë, Novobërdë, Mamushë, Vushtrri, Obiliq, Ranillug dhe Zubin Potok nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim/aktivitet për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpije në ekstremizëm të dhunshëm.

Më qëllim të luftimit të korrupsionit, komunitetet kanë deklaruar rastet e konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal. Kështu, gjatë vitit 2020 në 35 komuna nuk ka pasur asnjë rast të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal, kurse në 3 komuna: Hani Elezit, Graçanicë dhe Rahovec kanë qenë 5 raste. Në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale (neni 38), para marrjes së vendimeve në kuvendin e komunës si dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje ku mund të vie në shprehje interesi personal apo material, anëtarët e kuvendeve obligohen të deklarojnë konfliktin e interesit. Lidhur me këtë çështje, në 35 komuna nuk ka pasur deklarime të konflikteve të interesit nga anëtarët e kuvendit, ndërsa në 3 komuna të tjera: Lipjan, Malishevë dhe Kaçanik kanë qenë 7 raste të deklarimit të konfliktit të interesit.

Për të përmirësuar efikasitetin e punës në administratë, përgjegjësinë vendimmarrëse, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve, komunitetet kanë hartuar Planet Lokale të Integritetit. Këto plane janë hartuar në 18 komuna, ndërsa mbetet për t'u kryer në 20 komuna: Obiliq, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Kamenicë, Zveçan, Hani Elezit, Prizren, Mitrovicë Jugore, Deçan, Dragash, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë dhe Shtërpçë. Përveç kësaj, nga 38 komuna vetëm 17 komuna kanë caktuar zyrtarët përgjegjës për raportim lidhur me zbatimin e Planeve Lokale të Integritetit, ndërsa 21 komuna të tjera nuk kanë caktuar zyrtarët përgjegjës, si: Malishevë, Suharekë, Novobërdë, Obiliq, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Junik, Prizren, Viti, Podujevë, Mitrovicë Jugore, Klllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë dhe Prishtinë.

IMAPlementimi efektiv i legjislacionit për trashëgiminë kulturore ka qenë pjesë e angazhimeve të vazhdueshme të organeve komunale. Sipas të dhënave, Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e kanë hartuar 5 komuna: Lipjan, Prizren, Rahovec, Skenderaj dhe Kaçanik, ndërsa sfidë mbetet hartimi i këtij

plani për komunat tjera. Në kuadër të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë në 27 komuna janë ndërmarrë veprime, si: fushata vetëdijësuese, shpërndarja e broshurave të ndryshme dhe njoftime, përgatitja e hartave dhe broshurave të cilat janë në numër të konsiderueshëm për qytetarët dhe vizitorët, investimet (restaurimet) në objektet e trashëgimisë kulturore, bashkëpunim me Qendrën Regjionale për Trashëgimi Kulturorë, organizime të vizitave në muze me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë, shenjëzim i zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, etj. Ndërsa, 11 komuna tjera, si: Novobërdë, Mamushë, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë Jugore, Podujevë, Kllokot, Hani të Elezit, Ranillug dhe Zubin Potok nuk kanë ndërmarrë asnjë aktivitet.

Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar 3 raste të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura në 2 komuna: Istog dhe Rahovec, për të cilat janë ndërmarrë masat përkatëse procedurale dhe ligjore. Po ashtu, në 15 komuna janë vendosur pajisjet për monitorimin e sigurisë të objekteve të trashëgimisë kulturore, përkatësisht të kishave ortodokse. Në 8 komuna: Gjilan, Shtime Suharekë, Novobërdë, Vushtrri, Obiliq, Ferizaj dhe Istog janë siguruar pjesërisht këto pajisje, si dhe në 15 komuna tjera: Kaçanik, Pejë, Rahovec, Glogoc, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Malishevë, Partesh, Prishtinë, Kamenicë, Kllokot, Hani i Elezit, Ranillug dhe Mitrovica Jugore nuk janë siguruar pajisjet e monitorimit të sigurisë.

Kanë vazhduar të jenë funksional edhe dy këshillat e themeluara në Rahovec dhe Prizren, përkatësisht: Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit. Në këtë drejtim, janë ndërmarr veprime nga komunat përkatëse, ku janë shqiptuar dënime mandatore, janë caktuar inspektorët komunal për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit të Prizrenit. Gjithashtu, ka vazhduar të jetë funksional Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe për të cilin janë alokuar fonde në vlerë prej 24,904.00 €. Sa i përket rehabilitimit të shtratit të lumit Lumbardhi, komuna e Prizrenit gjendet në proces të rehabilitimit.

Në Komunën e Fushë Kosovës është duke u bërë studimi i fizibilitetit për themelimin e Muzeut të Natyrës i cili është duke u ndërtuar në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kriteret ekonomike

Zhvillimi ekonomik mbetet një nga prioritetet kryesore në nivel vendi. Politikat ekonomike përbëjnë substancën programore pothuajse të të gjithë mekanizmave të administratës shtetërore, përfshirë këtu komunat të cilat kanë një rol të padiskutueshëm në këtë drejtim. Në vitin 2020 ka vazhduar iMAPLementimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, ndërkohë janë duke u bërë ndryshimet në ligjin për financat e pushtetit lokal. Këto ndryshime strukturore përfshijnë opsionet përkatëse që ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të komunave, krijimin e kushteve për zhvillim të bizneseve, rritjen e investimeve kapitale, balancimit të investimeve sipas vlerësimeve reale, shfrytëzimit efikas të pronës komunale për investime nga jashtë, si dhe në shumë sektorë të tjerë të ndikimit.

Sa u përket aktiviteteve konkrete të parapara në planet e komunave, gjatë vitit 2020 në 31 komuna janë krijuar kushte të nevojshme për funksionimin e qendrave *one-stop-shop*, të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese, përfshirë regjistrimin e tyre, i cili është më i lart se sa në vitin 2019 ku ishin 28

komuna ato të cilat kishin funksionalizuar këto qendra. Megjithëse, janë edhe 7 komuna tjera të cilat ende nuk i kanë funksionalizuar qendrat për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et), si: Mamushë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan, Prishtinë, Partesh dhe Junik.

Duke marrë parasysh ndikimin e pandemisë globale të COVID 19 në vend, komunat kanë ofruar mbështetje financiare për bizneset lokale. Kështu, sipas të dhënave, janë 15 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje financiare me vlerë prej 1,369,069.08 euro. Ndërsa, 23 komuna tjera, si: Lipjan, Malishevë, Gjilan, Suharekë, Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Viti, Partesh, Istog, Kllokot, Zveçan, Hani i Elezit dhe Ranillug nuk kanë ndarë mjete buxhetore.

Në shumicën e komunave problemet që vështirësojnë kushtet e të bërit biznes konsiderohen: tregu i pasigurt për plasimin e produkteve, kreditë jo të favorshme për biznese, mungesa e investimeve strategjike dhe investimeve direkte nga jashtë, mungesa e subvencionimit të bizneseve për vendet e reja të punës, konkurrenca jolojale, ekonomia joformale, kosto e lartë e operimit, mungesa e fuqisë punëtore të profesionalizuar. Në këtë drejtim 13 komuna kanë hartuar Strategjitë për zhvillim ekonomik lokal, 6 komuna janë në proces të hartimit, 2 komuna: Kaçanik dhe Malishevë kanë strategjitë të cilat ju ka skaduar afati, 3 komuna: Deçan, Leposaviq dhe Zubin Potok nuk kanë strategji dhe 14 komuna të tjera: Pejë, Mamushë, Prizren, Viti, Prishtinë, Ferizaj, Rahovec, Kamenicë, Junik, Dragash, Partesh, Novobërdë, Kamenicë dhe Kllokot posedojnë plane zhvillimore komunale.

Për të ndikuar në luftimin e ekonomisë joformale, në 29 komuna janë të angazhuar 63 inspektorë të tregut. Ndërsa, janë 9 komuna: Novobërdë, Zubin Potok, Mamushë, Prishtinë, Zveçan, Leposaviq, Shtërpçë, Mitrovicë Veriore dhe Shtime të cilat ende nuk kanë inspektor të tregut. Niveli i koordinimit në mes të inspektoratit të tregut komunal me atë qendror është i vazhdueshëm me anë të takimeve të rregullta. Në këtë drejtim, në 29 komuna janë ndërmarr veprime si: vërejtje me gojë dhe me shkrim, inspektime mbi posedimin certifikatave të regjistrimit të bizneseve dhe lëshimin e faturave-kupon fiskal, inspektime në subjekte të cilat janë gjendur duke ushtruar veprimtari pa qenë të regjistruara (ekonomi jo-formale) ndaj të cilëve janë marrë masat e përcaktuara me ligj etj. Ndërsa, 9 komuna: Zubin Potok, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Ranillug nuk kanë ndërmarr masa.

Sa i përket planifikimit të pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal, janë 24 komuna të cilat kanë publikuar regjistrin e pronës komunale në ueb faqen zyrtare të komunës, ndërsa në 14 komuna tjera: Gjilan, Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Prishtinë, Podujevë, Istog, Zveçan dhe Hani i Elezit nuk është bërë publikimi i regjistrit. Po ashtu, në 12 komuna është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike, ndërsa në 21 komuna: Ferizaj, Gjakovë, Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Prishtinë, Podujevë, Istog, Zveçan, Hani i Elezit, Kllokot, Fushë Kosovë dhe Kamenicë nuk është bërë ende funksionalizimi, si dhe 5 komuna: Lipjan, Malishevë, Gjilan, Vushtrri dhe Prizren gjenden në proces të funksionalizimit të këtyre zonave.

Komunat po ashtu, janë koncentruar edhe në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, ngase sfida mbetet sidomos shpenzimi i mjeteve buxhetore në kategorinë e shpenzimeve kapitale. Zbatimi i rekomandimeve të auditorit ndikon në përmirësimin e menaxhimit të financave publike për një performancë sa më të mirë dhe shërbime më të mira ndaj qytetarëve. Gjatë vitit 2020, nga 38 komuna raportuese 33 prej tyre kanë pranuar 455 rekomandime nga Auditori i Përgjithshëm. Prej tyre të adresuar janë 256 rekomandime ose 56%, të pa adresuara mbesin 112 rekomandime ose 25% dhe 87 rekomandime gjenden në proces ose 19%. Nga këto rekomandime, janë pranuar 119 rekomandime financiare dhe 37 rekomandime të performancës. Për përmirësimin e menaxhimit të financave lokale 32 komuna kanë ndërmarr veprime përfshirë këtu: formimin e grupit punues për zbatimin e rekomandimeve të auditorit, hartimin e planit të veprimit për iMAPLementimin e rekomandimeve të auditorit, përgatitjen e listës së rreziqeve dhe raportit vetëvlerësues, rritjen e llogaridhënies, etj. Njësia e Auditimit të Brendshëm është e funksionalizuar në 28 komuna, ndërsa janë 11 komuna, si: Mamushë, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Partesh, Zveçan, Hani i Elezit, Obiliq, Podujevë, Klllokot dhe Fushë Kosovë të cilat ende nuk e kanë funksionale këtë njësi.

Standardet Evropiane

Komponentë kryesore e zhvillimit ekonomik lokal mbetet sektori i bujqësisë, përkatësisht zbatimi i duhur dhe efektiv i politikave të cilat janë thelbësore për funksionimin e politikave të përbashkëta bujqësore evropiane. Nga gjithsej 38 komuna, vetëm 6 komuna: Lipjan, Prishtinë, Podujevë, Kamenicë, Glllogoc dhe Junik kanë hartuar Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, ndërsa Plani për Menaxhimin e Tokave Rurale është i hartuar vetëm në 2 komuna: Lipjan dhe Shtime.


Në 33 komuna janë funksionale qendrat për informimin e bujqve, kurse në 5 komuna: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Klllokot dhe Zubin Potok ende nuk janë funksionale këto qendra. Janë 29 komuna të cilat kanë ofruar mbështetje për 6952 fermerë për kultivimin e bujqësisë në sektorë të: blegtorisë, pemëtarisë, drithërave, perimtarisë, përfitues të kultivimit me Bimë Mjekësore dhe Aromatike (BMA) etj. Ndërsa, 9 komuna: Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik dhe Klllokot gjatë këtij viti nuk kanë ofruar mbështetje për fermerët.

Për mbrojtjen e tokave bujqësore dhe promovimin e rëndësisë së tokave bujqësore, 10 komuna kanë ndërmarr fushata vetëdijesuse, ndërsa 29 komuna: Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Partesh, Istog, Hani i Elezit, Kamenicë, Gjakovë, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Podujevë dhe Klllokot të cilat nuk kanë ndërmarr masa. Sipas të dhënave, në 16 komuna janë të sistemuar inspektor të bujqësisë, derisa janë 22 komuna: Vushtrri, Obiliq, Malishevë, Gjakovë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Zveçan, Mitrovicë Jugore, Partesh, Dragash, Kaçanik, Glllogoc, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Pejë dhe Gjilan të cilat ende nuk kanë inspektorë të bujqësisë. Gjithashtu, numri i inspektimeve bujqësore në 14 komuna është 4229, kurse 24 komuna: Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Malishevë, Mamushë, Gjilan, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Podujevë, Klllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë, Dragash, Kaçanik, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë

dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë pasur inspektive. Lidhur me këto inspektive në 8 komuna: Gjakovë, Lipjan, Shtime, Vushtrri, Prishtinë, Prizren, Gllogoc dhe Rahovec numri i fletëparaqitjeve të parashtruara është 218.

Një numër i aktiviteteve janë zhvilluar edhe në fushën e energjisë efiçiente. Plani për energji efiçiente është hartuar në 32 komuna. Duhet marrë veprime që këto plane të hartohen edhe në 6 komuna që nuk i kanë në dispozicion, si: Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq.

Komunat kanë shënuar progres në krijimin e mekanizmave lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit. Konform obligimeve ligjore, 32 komuna kanë caktuar zyrtarin për mbrojtje nga diskriminimi. Kjo çështje mbetet e pazbatuar në 6 komuna tjera, si: Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë dhe Istog të cilat ende nuk kanë emëruar zyrtarin përkatës.



Diagrami 12: Mekanizmat lokal për zbatimin e ligjit kundër diskriminimit.

Komunat kanë vazhduar aktivitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Janë 21 komuna të cilat kanë zhvilluar aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut si: ligjërata nëpër shkolla, sesione informuese dhe këshillëdhënëse, fushata vetëdijësuese, etj. Ndërsa në 17 komuna: Lipjan, Vushtrri, Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Partesh, Kllokot, Zveçan, Fushë Kosovë dhe Istog nuk ka pasur aktivitete.

Gjithashtu, në 8 komuna është hartuar Strategjia dhe plani i veprimit kundër dhunës në familje: Lipjan, Gjakovë, Istog, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Dragash dhe Skenderaj, ndërsa në komunat tjera ende jo. Autoritetet komunale kanë ndërmarrë masa edhe për parandalimin e dhunës në familje. Në 23 komuna

janë paraqitur 1212 raste të dhunës në baza gjinore, kurse në 15 komuna: Malishevë, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Deçan, Dragash, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Podujevë, Partesh, Lipjan dhe Istog nuk ka pasur raste të paraqitura të dhunës. Për këtë qëllim 20 komuna kanë themeluar Këshillat Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe kanë zhvilluar 39 takime, kurse 18 komuna: Deçan, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Ferizaj, Novobërdë, Vushtrri, Gjakovë, Mamushë, Ranillug dhe Zubin Potok nuk kanë themeluar ende.

Ligji për Barazi Gjinore parasheh përcaktimin e masave të përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta të grave dhe burrave, si dhe përcakton subjektet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për hartimin dhe zbatimin e akteve normative për zhvillimin e barazisë gjinore në shoqëri. Me qëllim që të respektohet dhe zbatohet barazia gjinore në nivelin lokal, në të gjitha komunat është emëruar zyrtari për barazi gjinore. Edhe pse jo në masën e duhur, punësimi i grave në nivel lokal është prezent në kuadër të pozitave menaxheriale sipas të dhënave të 38 komunave. Gjatë kësaj periudhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga komunat për të përkrahur zbatimin e politikave gjinore, ku në 38 komuna numri i grave në pozita menaxheriale është 1859. Krahas tyre, në administratën publike lokale duke përfshirë edhe kuvendin e komunës në 38 komuna, janë të përfshira 3669 gra. Në Raportin e Vendit për Kosovën 2020 nga Komisioni Evropian, theksohet se “Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në vendimmarrjen lokale dhe aktualisht nuk ka kryetare femra në asnjë prej komunave të Kosovës. Nga 38 kryetarë të komunave të Kosovës, 27 janë nga komuniteti shqiptar, 10 nga komuniteti serb dhe 1 është nga komuniteti turk. Të gjitha komunat kanë përbushur detyrimin e tyre për të emëruar nënkryetarët e komunave nga komunitetet jo-shumicë”⁶.

Gjithashtu, në 38 komuna janë emëruar vetëm 2 gra nënkryetare në komunën e Suharekës dhe Zubin Potokut dhe në 10 komuna ku duhet të ekzistoj pozita e nënkryetarit për komunitete vetëm 1 grua ushtron këtë pozitë. Krahas kësaj, janë zgjedhur vetëm 6 gra kryesuese të kuvendeve të komunave: Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë, Skenderaj, Shtime, Zveçan, ndërkohë në 38 komuna janë emëruar drejtorë të drejtorive komunale apo gjithsejtë 377 drejtorë. Nga këto të dhëna vërejmë se, janë 95 gra të emëruara në këto pozita, ndërsa pjesa tjetër 282 janë burra. Në Komunën e Glllogocit, Klllokotit dhe Kamenicës 50 % të këtyre pozitave udhëhiqen nga gratë. Pra, gratë e përfaqësuar në pozita vendimmarrëse shprehur me përqindje janë 25.2 %, ndërsa pjesa tjetër ose 74.8 % burra, komuna e Kamenicës prinë me 7 drejtorë të udhëhequra nga gratë nga gjithsej 11 drejtorë dhe komuna e Glllogocit nga 10 drejtorë, pesë (5) prej tyre janë gra.

Progres është parë edhe në ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e të drejtave pronësore të grave. Së këndejmi, në 30 komuna janë zhvilluar fushata sensibilizuese, tryeza dhe seminare, ndërsa 8 komuna: Gjakovë, Zubin Potok, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Istog, Zveçan dhe Hani i Elezit nuk kanë ndërmarr veprime.

Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, kanë dalë edhe disa veprime të cilat obligojnë komunat që të ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e këtij ligji. Në këtë drejtim, 18 komuna kanë

⁶ Komisioni Evropian: “Raporti për Kosovën 2020”, Bruksel, 6.10.2020, fq. 12.

caktuar zyrtarët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve, përderisa në 20 komuna: Malishevë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Glllogoc, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Novobërdë, Prizren, Istog, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevës dhe Klllokot ende nuk janë caktuar zyrtarët në fjalë. Për rritjen e vetëdijesimit mbi këtë ligj në 13 komuna janë organizuar fushata vetëdijesuese, ndërsa 23 komuna: Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Suharekë, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rahovec, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevë, Istogut, Klllokot dhe Zveçan nuk është zhvilluar asnjë fushatë. Megjithëse, janë 7 komuna: Lipjan, Mamushë, Kaçanik, Pejë, Malishevë, Gjilan dhe Mitrovicë Veriore të cilat kanë ndarë mjete financiare për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Çështja e luftës së trafikimit kundër qenieve njerëzore, vazhdon që të jetë sfidë edhe për nivelin lokal. Gjatë periudhës raportuese, 7 komuna: Lipjan, Ferizaj, Novobërdë, Suharekë, Partesh, Mitrovicë dhe Pejë kanë funksionalizuar strehimoret për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, ndërsa në komunat tjera nuk është raportuar për raste të strehimit. Gjithashtu, në 9 komuna janë paraqitur 115 raste të strehimit dhe kompensimit të viktimave të trafikimit për të cilat raste është siguruar ndihmë nga komunat. Sa i përket miratimit të Planit tre-vjeçar për strehim social në 13 komuna është hartuar ky plan, përderisa janë 25 komuna tjera, si: Malishevë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Obiliq, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Klllokot, Zveçan, Kamenicë, Hani i Elezit, Ranillug, Zubin Potok dhe Partesh të cilat ende nuk kanë hartuar këtë plan.

Për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve për qytetarë, komunat janë kujdesur të krijojnë mekanizma të brendshëm për ofrimin e ndihmës juridike falas të cilat zyre në bazë të legjislacionit në fuqi themelohen përmes zyrave rajonale në 7 regjione. Sipas të dhënave zyrtare për ndihmë juridike falas janë funksionale vetëm në 5 regjione: Ferizaj, Gjilan, Gjakovë, Pejë dhe Prizren. Ndërsa zyrtarët për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 12 komuna, në 26 komuna: Gjilan, Shtime, Mamushë, Obiliq, Lipjan, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Prishtinë, Klllokot, Zveçan, Fushë Kosovë, Hani i Elezit, Viti, Podujevë, Partesh, Kamenicë, Novobërdë, Vushtrri, Ranillug dhe Zubin Potok ende nuk janë themeluar. Numri i personave të cilët kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë periudhës raportuese është 1803.

Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve janë shtrirë në 17 komuna ku ato kanë themeluar komitetet lokale, ndërsa në 15 komuna: Gjilan, Novobërdë, Mamushë, Kaçanik, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Podujevë, Klllokot, Kamenicë, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Jugore nuk kanë themeluar. Si dhe në 6 komuna tjera: Hani i Elezit, Partesh, Ranillug, Junik, Dragash dhe Glllogoc nuk ka komunitete rom, ashkali dhe egjiptian. Komunat janë ndër aktorët më të rëndësishëm për krijimin e kushteve relevante për riintegrimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar. Nga raportimi i komunave shohim se 12 komuna kanë miratuar Planin Komunal për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndërsa në 20 komuna: Vushtrri, Malishevë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Klllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Shtërpçë, Leposaviq, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Pejë, Gjilan, Zveçan, Suharekë dhe Mamushë nuk është hartuar plani. Si dhe në 6 komuna: Hani i Elezit, Partesh, Ranillug, Junik, Dragash dhe Glllogoc nuk ka komunitete rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas të dhënave për 13 komuna, numri i personave të regjistruar nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë 5438. Në rritjen e numrit të aplikimeve për regjistrim kanë ndikuar fushatat sensibilizuese të organizuara nga komunat. Kësisoj janë organizuar fushata vetëdijësuese në 9 komuna, ndërsa në 23 komuna: Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Gjakovë, Suharekë, Novobërdë, Vushtrri, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Rahovec, Leposaviq, Graçanicë, Viti, Podujevë, Istog, Fushë Kosovë, Klllokot, Kamenicë, Zubin Potok, Mitrovicë, Gjilan dhe Zveçan nuk janë realizuar fushata, si dhe në 6 komuna nuk ka rom, ashkali dhe egjiptian. Për mbrojtjen e komuniteteve jo shumicë, 20 komuna kanë ndarë buxhet në vlerë prej 461,090.00 euro.

Në fushën e riintegrit sipas të dhënave janë 25 komuna të cilat kanë arrit që të hartojnë këto plane, ndërsa 13 komuna: Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prizren, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Peja, Klllokot dhe Ferizaj ende nuk e kanë hartuar këto plane.

Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur dhe përkrahja nga niveli lokal ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Sipas të dhënave numri i personave të zhvendosur në 20 komuna është 1985, ndërsa në 18 komuna tjera: Lipjan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Hani Elezit, Prishtinë, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Kaçanik, Leposaviq, Skenderaj, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore nuk ka pasur persona të zhvendosur. Si rrjedhojë për personat e rikthyer në 13 komuna: Gjakovë, Obiliq, Novobërdë, Istog, Fushë Kosovë, Prizren, Kamenicë, Deçan, Klinë, Rahovec, Pejë, Shtërpçë dhe Graçanicë janë ndërtuar 147 shtëpi. Përveç kësaj, lidhur me aplikimin për asistencë nga fondi për ri-integrim në 17 komuna numri i aplikimeve është 318 persona, ndërsa numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar në 13 komuna është 25. Kurse, numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale në 15 komuna është 705.

Komunat janë përgjegjëse për ofrimin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve në kuadër të arsimit gjithëpërfshirës, 32 komuna kanë pasur veprime në zhvillimin e avancimit të mësimdhënësve, kurse në 6 komuna: Mamushë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Skenderaj, Kaçanik dhe Partesh nuk ka pasur veprime të tilla. Lidhur me pjesëmarrjen e fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor, në 29 komuna numri i fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është 7502 fëmijë ndërsa në 9 komuna: Mamushë, Podujevë, Partesh, Mitrovicë Veriore, Obiliq, Novobërdë, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan nuk kanë fëmijë të përfshirë të kësaj moshe.

Numri i fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor në 27 komuna është 749, kurse në 11 komuna: Shtime, Novobërdë, Zubin Potok, Ranillug, Klllokot, Partesh, Zveçan, Dragash, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë fëmijë me nevoja të veçanta të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor. Çështja e braktisjes së shkollimit nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ka qenë e evidente ndër vite, sipas të dhënave ky numër në 7 komuna është 121. Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mos regjistrimit të shkollimit për komunitet jo shumicë është i hartuar vetëm në 7 komuna: Gjakovë, Shtime, Obiliq, Pejë, Vushtrri, Fushë Kosovë dhe Istog. Kurse, janë 25 komuna të cilat kanë formuar ekipet vepruese për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla, si dhe 13 komuna: Malishevë, Novobërdë, Ranillug, Dragash, Mitrovicë e Veriut,

Leposaviq, Graçanicë, Junik, Zveçan, Klllokot, Partesh, Zubin Potok dhe Kamenicë nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

Komunat përballen me vështirësi të shumta në fushën e mjedisit, menaxhimit e mbeturinave, ndotjen e ajrit dhe deponitë e parregullta. Me qëllim të zbatimit Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, 32 komuna kanë hartuar planin për menaxhimit e mbeturinave komunale, ndërsa 6 komuna: Shtërpçë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Malishevë, Zveçan dhe Zubin Potok ende nuk kanë hartuar këtë plan. Po ashtu, në 20 komuna janë zhvilluar 99 fushata, ndërsa 18 komuna: Ferizaj, Novobërdë, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Hani Elezit, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Partesh, Deçan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Leposaviq, Shtërpçë, Junik dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë zhvilluar asnjë fushatë.

Inventari për mbeturina të rrezikshme është përgatitur vetëm në 1 komunë (Istog), ndërsa në 37 komuna tjera nuk është përgatitur. Hartimi i planit të veprimit për cilësinë e ajrit mbetet sfidë e theksuar e komunave ku vetëm 1 komunë (Glllogoc) kanë hartuar këtë plan. Përkundër kësaj, numri i deponive ilegale është tejet i madh, në 34 komuna numri i tyre është 1267, ndërsa në 4 komuna: Partesh, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore nuk ka deponi ilegale.

Në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës 13 komuna kanë organizuar trajnime për shëndetin e nënës dhe fëmijës, ndërsa në 25 komuna: Gjilan, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Glllogoc, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Podujevë, Partesh, Fushë Kosovë, Klllokot, Zveçan, Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Gjakovë, Shtime, Mamushë dhe Ranillug nuk kanë organizuar asnjë trajnim. Sa i përket numrit të inspektimeve për zbatimin e Ligjit kundër duhanit në 20 komuna janë realizuar 2208 inspektime, derisa në 18 komuna: Gjakovë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Mamushë, Gjilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Partesh, Zveçan, Kaçanik, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore nuk ka pasur inspektime. Ndërsa në fushën e shëndetit publik konkretisht në zbatimin e ligjit kundër duhanit në 20 komuna janë bërë 2208 inspektime. Kurse numri i gjobave të shqiptuara në 12 komuna është 987 ndërkaq në 26 komuna: Gjakovë, Ferizaj, Obiliq, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Mamushë, Gjilan, Fushë Kosovë, Prishtinë, Podujevë, Klllokot, Partesh, Zveçan, Deçan, Glllogoc, Dragash, Kaçanik, Leposaviq, Rahovec, Pejë, Shtërpçë, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore nuk është shqiptuar asnjë gjobë.

Veprimet e komunave kundrejt “luftës” me pandeminë globale, sipas raportimit të tyre. Gjatë vitit 2020 Kosova sikurse vendet tjera është ballafaquar me pandeminë globale të COVID 19. Masat e ndërmarra nga Qeveria kundër pandemisë COVID-19 si dhe rekomandimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës në vazhdimësi janë zbatuar nga shumica e komunave. Në anën tjetër, sipas të dhënave në 27 komuna kanë raportuar se si rezultatet i mos zbatimit të masave anti covid janë shqiptuar 5435 gjoba, ndërsa në 11 komuna: Gjakovë, Lipjan, Ferizaj, Ranillug, Podujevë, Viti, Partesh, Zveçan, Mitrovicë, Rahovec dhe Graçanicë nuk është shqiptuar asnjë gjobë.

Me qëllim të menaxhimit sa më efikas të pandemisë globale të COVID 19, komunat kanë ndërmarr një numër të madh të masave për parandalimin e pandemisë COVID-19 ku 37 komuna: janë themeluar shtabet emergjente komunale, janë bërë dezinfektimet e gjitha objekteve, janë bërë instalimet e tuneleve

dezinfektuese, janë zbatuar masat dhe rekomandimet nga MSH, është ofruar përkujdesje shëndetësore ndaj personave të prekur me COVID 19, është ofruar ndihmë për familjet me nevoja, është bërë aktivizimi i administratorëve të fshatrave, janë ngritur tenda për kontrolle paraprak për personat me simptomat e virusit pandemik, është ofruar kontribut në kompanitë publike me pajisje për mbrojtje nga virus, janë zhvilluar një sërë ligjëratash online me profesionistë të fushave të ndryshme, etj. Ndërsa, 1 komunë (Zveçan) nuk ka ofruar të dhëna. Sa i përket ndarjes së mjeteve për menaxhimin e pandemisë, nga 38 komuna gjithsej 33 prej tyre kanë ndarë mjete financiare për menaxhimin e pandemisë së COVID – 19 në vlerë prej 8,018,484.98 euro. Ndërsa, 2 komuna: Novobërdë dhe Kllokot nuk kanë ndarë mjete, si dhe 3 komuna tjera: Graçanicë, Zveçan dhe Partesh nuk kanë ofruar të dhëna. Si rezultat i ndikimit të pandemisë në vend janë mbyllur 592 biznese në 21 komuna.

Bashkëpunimi komunal dhe ndërkufitar i komunave. Është parë një interesim i komunave për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhë janë ndërmarrë 21 iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal nga 39 komuna. Këto iniciativa janë ndërmarrë me qëllim të bashkëpunimit në fushën e parandalimit, reagimit dhe ripërtëritjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Sa i përket Bashkëpunimi komunal ndërkombëtar, në kuadër të kësaj fushe është realizuar 1 marrëveshje në mes të komunës: Gjilan – Sioux City (Iowa) , në fushën ekonomike, teknologjike, kulturore, rini, sport, trashëgimi kulturore dhe shoqërore, si dhe nxitje të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020. Sa i përket bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, janë ndërmarrë veprime për iniciativa të reja për bashkëpunim dhe arritje të marrëveshjeve ndërmjet komunës së Ferizajt me qytetin e Cedar Falls të shtetit të IOWA-s, si dhe komunës së Podujevës me qytetin e Ames të shtetit të IOWA-s

FINANCAT LOKALE

Komunat kanë burime të shumta të financimit me të cilat disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në përputhje me ligjet e zbatueshme. Burimet financiare komunale kërkohet të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Financat lokale janë pjesë përbërëse e KASH-it, si dokument strategjik 3-vjeçar që hartohet mbi bazën e prioriteteve dhe objektivave të Qeverisë. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave, si dhe pjesëmarrja bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal.

Burimet financiare të një komune përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grantet operative, grantet për kompetencat e shtuara, transferet për kompetencat e deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga Republika e Serbisë dhe të hyrat nga huamarrjet e komunës. Komunat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi gjatë disponimit me këto burime financiare. Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mbliidhen nga taksat, tarifatat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkëpagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.

Në këtë pjesë të raportit jepen të dhëna të rëndësishme për planifikimin e të hyrave vetanake të komunave për vitin 2020, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet e buxheteve komunale.

Planifikimi i të hyrave vetanake

Për vitin 2020, planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë në vlerë prej 83,116,578.00 €. Krahasuar me të hyrat e planifikuara për vitin 2019 në vlerë prej 87,000,000.00 €, planifikimi për vitin 2020 ka qenë më i ulët për 3,883,422.00€ ose shprehur në përqindje 4.46%.

Realizimi i të hyrave vetanake

Komunat i mbledhin të hyrat vetanake në dy forma: a) si të hyra të mbledhura drejtpërdrejt nga komuna (si aktivitet i komunës) dhe b) si të hyrat të arkëtuara nga niveli qendror (të hyrat indirekte), të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake. Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2020 ka arritur vlerën prej 75,149,934.55€, prej të cilave 65,838,712.14€ kanë qenë të hyra direkte dhe 9,311,222.41€ kanë qenë të hyra indirekte. Nëse kjo vlerë krahasohet me vlerën totale të planifikuar, në shumën prej 83,116,578.00€, atëherë shohim që realizimi ka arritur nivelin prej 90%. Inkasimi i të hyrave vetanake direkte për vitin 2020 në vlerë prej 65,838,712.14€ krahasuar me inkasimin e të hyrave të llojit të njëjtë për vitin 2019 në vlerë prej 77,813,475.88€, është më i ulët për diferencën prej 11,974,763.74 €, apo 15.39%.


Sipas të dhënave zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, komunat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2020 kanë grumbulluar shumë më prej 65,838,712.14 € të hyra vetanake direkte ose 87.6% nga niveli i planifikuar vjetor prej 75,149,934.55 €.

Në bazë të përqindjes së inkasimit të të hyrave vetanake, komunat kanë nivelin e realizimit si vijon:

- Të hyra vetanake me përqindje më të madhe apo mbi 100% kanë realizuar këto komuna: Graçanicë, Rahovec, Vushtrri dhe Partesh;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 80-100% kanë realizuar këto komuna: Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Mamushë, Klinë, Pejë, Kaçanik dhe Klllokot;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 60-70% kanë realizuar këto komuna: Glllogoc, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Suharekë, Malishevë, Gjakovë, Istog, Junik, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Ferizaj, Viti dhe Hani i Elezit;
- Të hyra vetanake me përqindje nga 0-50% kanë realizuar këto komuna: Shtime, Dragash, Deçan, Leposaviq, Skenderaj, Zubin Potok, Zveçan, Shtërpçë dhe Ranillug.

Kategoritë që kanë ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë:

- Tatimi në pronë gjatë vitit 2020 ka qenë në vlerë prej 22,798,466 €, kurse për vitin 2019 ka qenë në vlerë 27,312,96 €, ku vërehet se kemi rënie në vitin 2020 për 4,514,494 €;
- Të hyrat komunale për regjistrim të automjeteve gjatë vitit 2020 kanë qenë në vlerë prej 3,622,585 €, përderisa në vitin 2019 ato kanë qenë 3,675,176 €, ku vërehet se kemi rënie në vitin 2020 për 52,591 €;
- Të hyrat komunale për leje ndërtimi në vitin 2020 kanë qenë 17,575,314 €, ndërsa në vitin 2019 këto të hyra kanë qenë 17,950,283 €, ku vërehet se kemi rënie në vitin 2020 për 3,749,69 €;
- Të hyrat nga regjistrimi i Trashëgimisë në vitin 2020 kanë qenë në vlerë prej 1,481,737 €, përderisa në vitin 2019 kjo shifër ka qenë 1,697,879 €, ku vërehet se kemi rënie në vitin 2020 për 216,142 €;
- Të hyrat nga ndërrimi i Destinimit i Tokës, në vitin 2020 kanë qenë 1,790,788 €, përderisa në vitin 2019 kjo shifër ka qenë në vlerën prej 2,111,487, ku vërehet një rënie në vlerë prej 320,699 €;
- Të Hyrat nga Dokumentet e Gjendjes Civile, në vitin 2020 kanë qenë në vlerë prej 2,304,110 €, ndërsa në vitin 2019 kjo shumë ka qenë 3,428,304 €, ku mund të shohim se ka pasur një rënie prej 1,124,194 €;
- Të hyrat nga bizneset, në vitin 2020 kanë qenë 1,258,229 €, kurse në vitin 2019 kjo shifër ka qenë në vlerë prej 1,618,357 € që do të thotë se ka pasur rënie në vlerë prej 360,128 €;
- Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike, në vitin 2020 kanë qenë në vlerë prej 3,755,610 €, ndërsa në vitin 2019 kjo shifër ka qenë 5,779,699 €, ku vërehet se ka rënie në vlerë prej 2,024,089 €;
- Të hyrat nga participimet në Arsim dhe Shëndetësi, në vitin 2020 kanë qenë në vlerë prej 3,073,070 €, kurse në vitin 2019 kanë qenë në vlerë prej 4,598,328 €, ku vërehet se ka rënie në vlerë prej 1,525,258 €;
- Të hyrat e tjera, në vitin 2020 kanë qenë në vlerë prej 8,178,803 €, kurse në vitin 2019 këto të hyra kanë qenë në vlerë prej 9,641,003 €, ku shihet se ka rënie në vlerë prej 1,462,200 €.



Diagrami 13: Krahasimi i të hyrave që kanë ndikim në rritjen e të hyrave vetanake gjatë vitit 2019 me vitin 2020.

Buxhetimi Komunal për vitin 2020

Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2020 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 528,890,940.44€ ose 85 % e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 625,747,812.12 €. Bazuar në gjendjen e fundit të raporteve vjetore në SIMFK, për vitin 2020 komunat e Kosovës kanë pasur në dispozicion buxhetin në shumë prej 625,747,812.12€ apo 52,166,696.99 €, më shumë krahasuar me vitin 2019 sa ishte 573,581,115.13€.

Shpenzimet krahasuar me buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike është shpenzuar si vijon:

- **Kategoria Rroga dhe Mëditje:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë në vlerë prej 273,094,963.90 €, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 272,360,101.74 € ose 99.73%. Krahasuar me buxhetin në të gjitha komunat është shpenzuar nga 99-100 %. Nga gjithsej 38 komuna, 32 komuna kanë shpenzuar buxhetin 100% dhe 6 komuna në 99%.

- **Kategoria Mallra dhe Shërbime:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë në vlerë prej 98,381,284.23 €, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 83,843,652.34 € ose 85%. Krahasuar me buxhetin e planifikuar është shpenzuar në nivelin nga 61- 100%, ku përqindjen më të ulët të realizimit të shpenzimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve e ka komuna e Shtimes me 65%, Gllogoci me 68%, Obiliqi me 69% dhe Podujeva me 69%. Kurse komunat të cilat kanë shpenzuar 90 - 100% në krahasim me buxhetin në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë komunat: Klllokot me 100%, Fushë Kosova me 94%, Graçanica me 94%, Rahoveci me 96%, Malishevë, 90%, Mamushë me 99%, Deçan me 97%, Gjakovë me 94%, Klinë me 95%, Pejë me 90%, Junik me 98%, Leposaviq me 99%, Zubin Potok dhe Zveçan me nga 96%, Mitrovicë Veriore me 97%, Gjilan 90%, Kaçanik 95%, Partesh 98% dhe Hani i Elezit 90%.
- **Kategoria Shpenzime komunale:** sipas të dhënave buxheti i planifikuar për këtë kategori ka qenë në shumë prej 11,652,699.45€, janë shpenzuar 10,100,898.83 € ose 87%. Krahasuar me buxhetin është shpenzuar në nivelin nga 7 - 100%. Komunat që kanë përqindjen më të ulët të realizimit të shpenzimeve në krahasim me buxhetin janë komunat: Zveçan me 25%, Ranillug me 49% dhe Klllokot me 55%. Kurse komunat që kanë arritur përqindjen më të lartë të realizimit të buxhetit prej 100% janë komunat: Malishevë, Mamushë, Deçan, Leposaviq, Viti dhe Hani i Elezit.
- **Kategoria Subvencione dhe Transfere:** në këtë kategori gjatë kësaj periudhe të planifikuar kanë qenë në shumë prej 33,566,339.27 € dhe janë shpenzuar 21,885,867.29 € ose 65%. Të dhënat flasin se, krahasuar me buxhetin është shpenzuar në nivelin 90 - 100% në 17 komuna, në 8 komuna është shpenzuar në nivelin 80 – 89%, në 7 komuna është shpenzuar në nivelin 70-79%, ndërsa në 6 komuna është shpenzuar në nivelin 10-69%.
- **Kategoria Shpenzime Kapitale (pasuritë jo-financiare), sipas të dhënave në këtë kategori buxheti i planifikuar ka qenë në shumë prej 209,052,525.27€, janë shpenzuar 140,700,420.24 € ose 67.30%. Te kjo kategori komunat kanë pasur disa vonesa të cilët kanë ndikuar tre faktorë: 1) ndryshimi i planit dinamik; 2) rishikimi i buxhetit apo shkurtimi në alokime si pasojë e rënies së të hyrave të përgjithshme buxhetore; 3) parashikimi që të hyrat vetanake të komunave janë zvogëluar. Krahasuar me buxhetin e planifikuar në 8 komuna është shpenzuar në nivelin 90- 100%, në 13 komuna është shpenzuar 80 – 89%, në 10 komuna është shpenzuar në nivelin 60 – 79% dhe në 7 komuna është shpenzuar 0-59%.**

Nëse bëjmë krahasimin në mes të kategorive ekonomike vërejmë se në vitin 2020 në kategorinë paga dhe mëditje është shpenzuar 8,928,306.38€ më shumë se në vitin 2019, në kategorinë e mallrave dhe shërbime në vitin 2020 është shpenzuar 19,675,493.76€ më shumë, në kategorinë e shpenzimeve komunale janë shpenzuar (-130,039,31€) me pak në krahasim me vitin 2020, si dhe në kategorinë e shpenzimeve kapitale janë shpenzuar (-3,470,957.75 €) me pak se në vitin 2020.

Shpenzimet nga programi për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE)

Ministria e Financave me qëllim të rritjes së transparencës si dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve lidhur me shpenzimet dhe menaxhimin e fondeve të programit për rimëkëmbje ekonomike (PRE) dhe raportimit të shpenzimeve të ndodhura në muajin nëntor 2020 ka dërguar udhëzimin lidhur me zotimet/shpenzimet e

mjeteve nga fondet e Programit për Rimëkëmbje ekonomike (PRE) dhe ka hapur një kod të ri pesë shifror (00098) i cili do të mund të përdoret për të gjitha burimet e financimit dhe të gjitha kategoritë ekonomike. Komunitet e Republikës së Kosovës nga Programi për Rimëkëmbjes Ekonomike kanë shpenzuar mjete në vlerë prej 8,439,425.73€ sipas kategorive ekonomike si në vijim:

Shpenzimet nga Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE)	
Pagave dhe mëditjeve	-
Mallra dhe shërbime	4,394,919.16 €
Shpenzime komunal	3,992,066.83 €
Subvencione dhe transfere	52,439.74 €
Shpenzime kapitale	-
Gjithsej	8,439,425.73 €

Tabela 1: Shpenzimet nga Programi për Rimëkëmbje Ekonomike (PRE).

Shpenzimet për Menaxhim Emergjent nga COVID 19

Ministria e Financave gjithashtu me qëllim të rritjes së transparencës si dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve lidhur me shpenzimet dhe menaxhimin e fondeve për luftimin e situatës së pandemisë (COVID-19), por edhe raportimit të shpenzimeve me mundësi rimbursimi në muajin prill 2020 ka hapur një kod të ri pesë shifror (00099) i cili do të mund të përdoret për të gjitha burimet e financimit dhe të gjitha kategoritë ekonomike (*përrjashtuar projektet kapitale*). Komunitet e Republikës së Kosovës për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19 kanë shpenzuar mjete në vlerë prej 17,600,984.16 € sipas kategorive ekonomike, si në vijim:

Shpenzimet për menaxhimin e emergjencës nga COVID-19	
Pagave dhe mëditjeve	10,835,160.00 €
Mallra dhe shërbime	4,092,946.40 €
Shpenzime komunal	1,857,405.00 €
Subvencione dhe transfere	815,472.76 €
Shpenzime kapitale	/
Gjithsej	17,600,984.16 €

Tabela 2: Shpenzimet për Menaxhim Emergjent nga COVID 19.

Komunitet përveç mjeteve nga grandit i përgjithshëm, për menaxhim të situatës me pandemi ka shpenzuar mjete edhe nga të hyrat vetanake, si në vijim:

- a) Menaxhimin e Emergjencës nga Covid-19 nga grandit i përgjithshëm - 15,743,082.36 €
- b) Menaxhimin e Emergjencës nga Covid-19 nga të hyrat vetanake 2019 - 346,427.60 €
- c) Menaxhimin e Emergjencës nga Covid-19 nga të hyrat vetanake 2018 - 1,511,474.20 €

Pra, për menaxhim të situatës pandemike në vend nga komunitet janë shpenzuar në total: 17,600,984.16 €.

Opinionit i auditorit për komunat e Republikës së Kosovës

Opinionet e auditorit për komuna janë të ndryshme sipas viteve. Lloji i opinionit i cili më së shumti është dhënë në vitet 2018 - 2019 është opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, i cili është dhënë në 17 komuna në vitin 2019 dhe në 32 komuna në vitin 2018. Opinion i pamodifikuar është dhënë në 21 komuna në vitin 2019 dhe në 3 komuna në vitin 2018. Opinionit i kualifikuar – me theksim të çështjes në vitin 2019 nuk e ka pasur asnjë komunë, kurse në vitin 2018 këtë lloj opinionit e kanë pranuar 3 komuna. Opinion të kualifikuar në vitin 2019 dhe 2018 nuk e ka pranuar asnjë komunë. Gjithashtu, Opinion të kundërt në vitin 2019 nuk është kualifikuar asnjë komunë po ashtu edhe në vitin 2018 nuk e ka pasur asnjë komunë. Vlen të cekët se Opinionit i cili ju mundëson komunave për të filluar me procedura të huas komunale duhet të kenë dy vite radhazi (dy vitet e fundit) është opinion i pamodifikuar dhe këtë opinion e ka komuna e Vitisë, Shtimes dhe Ranillugut. Në vijim mund të shihni pasqyrën me të dhëna lidhur me këto opinione të auditorit sipas komunave dhe sipas viteve:

Opinionit i auditorit	Vitet	Komunat
Opinion i pamodifikuar	2018	Viti, Shtime dhe Ranillug (3)
	2019	Deçan, Gjilan, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Obiliq, Partesh, Podujevë, Ranillug, Shtërpçë, Shtime, Vitia, Zveçan, Leposaviq, Dragash, Junik, Istog, Hani i Elezit (21)
Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes	2018	Skenderaj, Mamushë, Malishevë, Klinë, Kamenicë, Kaçanik, Junik, Hani i Elezit, Dragash, Deçan, Rahovec, Glogoc, Mitrovica e Veriut, Obiliq, Zveçan, Zubin Potok, Vushtrri, Suharekë, Prizren, Podujevë, Pejë, Partesh, Mitrovicë Jugore, Lipjan, Leposaviq, Klokot, Istog, Graçanicë, Gjilan, Gjakovë, Fushë Kosovë, Prishtinë (32)
	2019	Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakova, Graçanicë, Kaçanik, Klokot, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prishtinë, Rahovec, Skenderaj, Suharekë, Vushtrri, Zubin Potok, Prizren, Glogoc (17)
Opinion i kualifikuar me Theksim të çështjes	2018	Shtërpçë, Novobërdë dhe Ferizaj (3)
	2019	
Opinion i kualifikuar	2018	
	2019	
Opinion i kundërt	2018	
	2019	

Tabela 3: Pasqyron opinionin e Auditorit për komunat e Republikës së Kosovës 2018 – 2019.

Rekomandimet

- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në komunat: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore;
- Komiteti për politikë dhe financa duhet të jetë më aktiv në komunën e Zubin Potokut;
- Të rritet intensiteti i takimeve të komitetit për komunitete në komunat: Prizren, Prishtinë, Gjilani, Zveçan dhe Zubin Potok;
- Komunat: Zubin Potok, Zveçan, Dragash dhe Mamushë të jenë më aktive në miratimin e akteve të kuvendit;
- Të arrihet kriteri minimal i dy raportimeve para kuvendit nga kryetarët e komunave: Deçan, Mamushë, Istog, Rahovec dhe Graçanicë dhe Kllokot;
- Të mbahen së paku dy takime publike në vit sipas nenit 68.1 të LVL-së nga komunat: Mamushë, Istog, Kamenicë, Partesh, Mitrovicë e veriut, Fushë Kosovë, Ranillug, Kllokot, Zveçan, Laposaviq, Zubin Potok dhe Novobërdë;
- Të bëhet migrimi dhe përditësimi i të dhënave nga ueb-faqet e vjetra në ato të reja në komunat: Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore;
- Të publikohen në ueb-faqe procesverbalet e mbledhjeve të kuvendeve në komunat: Gjilan, Junik, Novobërdë, Prizren, Shtërpcë, Laposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut;
- Të publikohen në ueb-faqe dokumentet buxhetore nga komunat: Glllogoc, Novobërdë, Partesh, Ranillug, Shtime, Viti, Zubin Potok, Zveçan, Laposaviq, Mitrovicë e Veriut;
- Të themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunat: Zveçan, Zubin Potok, Laposaviq dhe Mitrovicë Veriore;
- Të zbatohet standardi minimal i Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi prej gjashtë apo më shumë takimeve nga komunat: Prizren, Deçan, Junik, Mamushë, Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Istog, Gjilan, Gjakovë, Kamenicë, Vushtrri, Klinë, Obiliq, Malishevë, Fushë Kosovë, Ranillug, Shtërpcë, Partesh, Graçanicë, Novobërdë dhe Podujevë;
- Të themelohen Ekipet Vepruese për Siguri (EVS) në komunat: Novobërdë, Mamushë, Deçan, Klinë, Skenderaj Mitrovicë e Veriut, Laposaviq, Shtërpcë, Mitrovicë Jugore, Kllokot dhe Ranillug;
- Të themelohen Këshillat Lokale për Siguri Publike në komunat: Novobërdë, Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Pejë, Junik, Shtërpcë dhe Ranillug, si dhe komunat: Hani i Elezit dhe Mitrovicë Jugore të ofrojnë të dhëna për këto forume;
- Komunat: Kamenicë, Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut, Fushë Kosovë dhe Partesh t'i harmonizojnë aktet e tyre konform kërkesave për rishqyrtim të dërguara nga autoriteti mbikëqyrës;
- Të hartohet programi i trajnimeve në komunat: Obiliq, Ranillug, Prishtinë, Podujevë, Shtërpcë dhe Mitrovicë e Veriut;
- Komunat: Obiliq, Shtime, Ferizaj, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Prizren, Viti, Mitrovicë, Prishtinë, Dragash, Glllogoc, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Laposaviq, Fushë Kosovë, Gjilan, Lipjan, Junik dhe Shtërpcë t'i hartojnë strategjitë për komunikim me publikun;
- Të ofrohet mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve nga komunat: Mamushë, Ferizaj, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Deçan dhe Shtërpcë;
- Komunat: Prizren, Prishtinë, Viti, Podujevë, Istog, Kllokot, Zveçan, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Shtërpcë, Mitrovicë e Veriut, Laposaviq, Graçanicë, Junik, Fushë Kosovë, Lipjan, Malishevë, Gjakovë, Novobërdë, Mamushë, Vushtrri, Obiliq, Ranillug dhe Zubin Potok të ndërmarrin

veprime/aktivitete për vetëdijesimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shprijë në ekstremizëm të dhunshëm.

- Të hartohet Plani Lokal i Integritetit në komunat: Obiliq, Ferizaj, Shtime, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllokot, Kamenicë, Zveçan, Hani Elezit, Prizren, Mitrovicë Jugore, Deçan, Dragash, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë dhe Shtërpçë;
- Të caktohen zyrtarët përgjegjës për raportim lidhur me zbatimin e Planeve Lokale të Integritetit në komunat: Malishevë, Suharekë, Novobërdë, Obiliq, Ranillug, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Junik, Prizren, Viti, Podujevë, Mitrovicë Jugore, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë dhe Prishtinë;
- Të hartohet Plani për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në komunat: Gjakovë, Gjilan, Shtime, Ferizaj, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Istog, Fushë Kosovë, Hani Elezit, Prishtinë, Podujevë, Kllokot, Viti, Partesh, Zveçan, Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Deçan, Glllogoc, Dragash, Klinë, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë, Junik, Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore;
- Të koMAPLetohet struktura e qendrave One-Stop-Shop duke shtrirë rrjetin e tyre edhe në komunat: Mamushë, Zubin Potok, Kllokot, Zveçan, Prishtinë, Partesh dhe Junik;
- Komunat: Lipjan, Malishevë, Gjilan, Suharekë, Novobërdë, Mamushë, Obiliq, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Viti, Partesh, Istog, Kllokot, Zveçan, Hani i Elezit dhe Ranillug duhet të ofrojnë mbështetje financiare për bizneset lokale;
- Të ndahen mjetet financiare për menaxhimin e pandemisë në komunat: Novobërdë dhe Kllokot si dhe të ofrohen të dhëna nga 3 komunat: Graçanicë, Zveçan, Partesh për mjetet e ndara financiare;
- Të hartohen Strategjitë për Zhvillim Ekonomik Lokal në komunat: Deçan, Leposaviq dhe Zubin Potok;
- Të publikohet regjistri i pronës komunale në ueb faqen zyrtare të komunave: Gjilan, Mamushë, Zubin Potok, Deçan, Klinë, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Junik, Prishtinë, Podujevë, Istog, Zveçan dhe Hani i Elezit;
- Të funksionalizohet njësia e auditimit në komunat: Mamushë, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Partesh, Zveçan, Hani i Elezit, Obiliq, Podujevë, Kllokot dhe Fushë Kosovë;
- Të formohen qendrat trajnuese të bujqve në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë, Kllokot dhe Zubin Potok;
- Të hartohet Plani për energji eficiente në komunat: Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq;
- Të caktohet zyrtari për mbrojtje nga diskriminimi në komunat: Mamushë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Podujevë dhe Istog;
- Të hartohet Strategjia kundër dhunës në familje në komunat: Malishevë, Ferizaj, Shtime, Mamushë, Novobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Prizren, Prishtina, Podujeva, Partesh, Deçan, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Glllogoc, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Gjilan, Peja, Fushë Kosovë, Kllokot, Hani Elezit dhe Zveçan;
- Të caktohen zyrtarët përkatës për mbrojtjen e fëmijëve në komunat: Malishevë, Deçan, Dragash, Klinë, Kaçanik, Rahovec, Glllogoc, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Novobërdë, Prizren, Istog, Zveçan, Fushë Kosovë, Obiliq, Zubin Potok, Podujevës dhe Kllokot;
- Të miratohet Plani tre-vjeçar për strehim social në komunat: Malishevë, Novobërdë, Vushtrri, Mamushë, Obiliq, Dragash, Klinë, Kaçanik, Junik, Rahovec, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Prishtinë, Viti, Mitrovicë Jugore, Istog, Kllokot, Zveçan, Kamenicë, Hani i Elezit, Ranillug, Zubin Potok dhe Partesh;

- Të zhvillohen fushata senzibilizuese, tryeza, seminare për ndërgjegjësimin dhe përmirësimin e të drejtave pronësore të grave në komunat: Gjakovë, Zubin Potok, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Istog, Zveçan dhe Hani i Elezit;
- Të hartohet Plani Komunal për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunat: Vushtrri, Malishevë, Ferizaj, Novobërdë, Zubin Potok, Kllokot, Fushë Kosovë, Kamenicë, Viti, Mitrovicë Jugore, Kaçanik, Shtërpçë, Leposaviq, Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Pejë, Gjilan, Zveçan, Suharekë dhe Mamushë;
- Të hartohet Plani Komunal për Ri integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në komunat: Mamushë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prizren, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Leposaviq, Graçanicë, Peja, Kllokot dhe Ferizaj;
- Komunat: Malishevë, Novobërdë, Ranillug, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Junik, Zveçan, Kllokot, Partesh, Zubin Potok dhe Kamenicë të themelojnë ekipet vepruese për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla;
- Të hartohet Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave në komunat: Shtërpçë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Malishevë, Zveçan dhe Zubin Potok;
- Të organizohen trajnime për shëndetin e nënës dhe fëmijës në komunat: Gjilan, Novobërdë, Zubin Potok, Deçan, Dragash, Klinë, Pejë, Glllogoc, Skenderaj, Shtërpçë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Graçanicë, Podujevë, Partesh, Fushë Kosovë, Kllokot, Zveçan, Lipjan, Ferizaj, Malishevë, Gjakovë, Shtime, Mamushë dhe Ranillug.

Botues

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministria e Pushtetit Lokal -

MAPL

<http://mapl.rks-gov.net/>

Adresa Ish ndërtesa e Rilindjes Katet: 10, 11, 12 dhe 13 Prishtinë, Republika e Kosovës +381 (0) 200 35 630 (centrale)